# **KURRIKULA E EDUKIMIT PARASHKOLLOR NË KOSOVË ( 3-6 VJEÇ)**

PËRMBAJTJA:

I. FILOZOFIA E EDUKIMIT PARASHKOLLOR……………………………………

II. PARIMET E EDUKIMIT PARASHKOLLOR…………………………………….

III. QËLLIMET E EDUKIMIT PARASHKOLLOR…………………………………

IV. FUSHAT E AKTIVITETIT………………………………………………………

IV. I. EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETI……………………………................
HYRJE…………………………………………………………………….....
IV.1. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR GRUP-MOSHA 3-6....................
IV.1. 2. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 3-4...............................
IV.1. 3. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS ............................................
IV.1. 4. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.1. 5. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 4-5................................
IV.1. 6. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS...............................................
IV.1. 7. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.1. 8. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 5-6.................................
IV.1. 9. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS.................................................
IV.1. 10. REZULTATETE E PRITSHME ...................................................................
IV.1. 11. INTEGRIMI NDËRFUSHORË ..................................................................

IV. II.GJUHA AMTARE………………………………………………….........
HYRJE…………………………………………………………………......
IV.2. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR GRUP-MOSHA 3-6....................
IV.2. 2. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 3-4...............................
IV.2. 3. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS ............................................
IV.2. 4. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.2. 5. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 4-5................................
IV.2. 6. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS...............................................
IV.2. 7. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.2. 8. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 5-6.................................
IV.2. 9. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS.................................................
IV.2. 10. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.2. 11. INTEGRIMI NDËRFUSHORË ....................................................................

IV. III. EDUKIMI ARTISTIK..........................................................................................
HYRJE…………………………………………………………………….........
IV.3 / 1.1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR GRUP-MOSHA 3-6.................
IV. III / I. EDUKIMI MUZIKOR..............................................................................
IV.3 / 1.2. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 3-4............................
IV.3 / 1.3. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS ..........................................
IV.3 / 1.4. REZULTATETE E PRITSHME ................................................................

IV.3 / 1.5. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 4-5............................
IV.3 / 1.6. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS..........................................
IV.3 / 1.7. REZULTATETE E PRITSHME ................................................................
IV.3 / 1. 8. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 5-6..........................
IV.3 / 1. 9. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS.........................................
IV.3 / 1. 10. REZULTATETE E PRITSHME .............................................................
IV.3 / 1. 11. INTEGRIMI NDËRFUSHORË ............................................................

IV.III / II EDUKIMI FIGURATIV....................................................................................
IV.3 / 2. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR GRUP-MOSHA 3-6...............
IV.3 / 2. 2. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 3-4.........................
IV.3 / 2.3. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS ..........................................
IV.3 / 2. 4. REZULTATETE E PRITSHME ............................................................
IV.3 / 2. 5. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 4-5..........................
IV 3 / 2. 6. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS.........................................
IV.3 / 2. 7. REZULTATETE E PRITSHME ............................................................
IV.3 / 2. 8. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 5-6..........................
IV.3 / 2. 9. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS..........................................
IV.3 / 2. 10. REZULTATETE E PRITSHME ..........................................................
IV.3 / 2. 11. INTEGRIMI NDËRFUSHORË ............................................................

IV.IV. HAPSIRA, RREGULLAT DHE PËRMASAT (MATEMATIKA)
HYRJE………………………………………………………………………
IV.4. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR GRUP-MOSHA 3-6....................
IV.4. 2. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 3-4..............................
IV.4. 3. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS ............................................
IV.4. 4. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.4. 5. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 4-5...............................
IV.4. 6. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS..............................................
IV.4. 7. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.4. 8. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 5-6...............................
IV.4. 9. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS..............................................
IV.4. 10. REZULTATETE E PRITSHME .................................................................
IV.4. 11. INTEGRIMI NDËRFUSHORË ..................................................................

IV.V. NJOHJA E VETËS DHE BOTËS
HYRJE……….......…………………………………………………………………
IV.5. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR GRUP-MOSHA 3-6....................
IV.5. 2. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 3-4..............................
IV.5. 3. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS ............................................
IV.5. 4. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.5. 5. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 4-5...............................
IV.5. 6. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS..............................................
IV.5. 7. REZULTATETE E PRITSHME ..................................................................
IV.5. 8. OBJEKTIVATE VEÇANTA PËR GRUP-MOSHA 5-6...............................
IV.5. 9. AKTIVITETE E MUNDSHME TË FËMIJËS..............................................

IV.5. 10. REZULTATETE E PRITSHME..................................................................
IV.5. 11. INTEGRIMI NDËRFUSHORË .......................................................................

## I. FILOZOFIA E EDUKIMIT PARASHKOLLOR

Studimet më të avansuara psikologjike e pedagogjike vërtetojnë se gjashtë vitet e para të jetës së fëmijës kanë ndikim të madh në formësimin e personalitetit të njeriut.

Në synim që zhvillimi i fëmijës deri në gjashtë vjeç të jetë sa më i suksesshëm, njerëzit e profesionit e të shkencës bëjnë përpjekje ta ndërgjegjësojnë shoqërinë për edukimi cilësor të fëmijëve parashkollore. Mirëpo, shkencat e ndryshme që studiojnë zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve nuk ofrojnë një të vetmën përgjigje univerzale në pyetjen**:"çfarë duhet të jetë edukimi parashkollor cilësor?".**

Me qëllim që **Filozofia e edukimit parashkollor në Kosovë** të jetë në hap me të arriturat shkencore, praktikat e përparuara dhe konform rrethanave specifike dhe synimeve të vendit , **duhet t`i ngërthejë në një sistem të integruar**, në një anë, këto të arritura dhe ,në anën tjetër, përvojat pozitive vendore e të vendeve më të përparuara.

Taban i Filozofisë së edukimit parashkollor është qëndrimi se edukimi është proces që nisë me jetën e fëmijës dhe vazhdon gjatë gjithë moshës parashkollore,duke vazhduar në periodat pasuese jetësore.

Edukimi i fëmijëve të grupmoshës deri në tri vjeç dhe i grupmoshës deri në gjashtë vjeç konsiston në zhvillimin e aspektit shëndetësor e fizik, emocional- ndjenjorë, mendor e social të tij.Nga se aspektet e personalitetit fillojnë të zhvillohen që në fëmijëri të hershme e vazhdojnë të zhvillohen në periodat pasuese jetësore, mu për këtë nuk arsyetohet tendenca e anashkalimit të procesit edukativ në grupmoshën deri në tri vjeç dhe identifikimit të këtij procesi me kujdesin shëndetësor dhe mirërritjen e fëmijës..Kjo tendencë, nuk ka mbështetje shkencore andaj, si e damshme për fëmijën parashkollor, nuk bënë të jetësohet në praktikën edukative në Kosovë.

Një tjetër ide e Filozofisë së edukimit parashkollor është respektimi i karakteristikave të përgjithshme të moshës së fëmijës parashkollor. Njëkohësisht afirmohet respektimi i dallimeve individuale midis fëmijëve me potencialin gjenetik të tyre, cilësinë dhe tempon e zhvillimit, specifikave në të nxënit, nivelit dhe cilësisë së paranjohurive, shkathtësive shprehive etj. Këto karakteristika janë fare individuale edhe nga arsyeja se i nxisin mikromjediset sociale të ndryshme në të cilat jeton dhe vepron fëmija, specifikat sociale dhe fizike në familje,ato në institucionet parashkollore shumë të ndryshme, mjedisi shoqërorë specifik i fëmijës, etj.

Filozofia e edukimit parashkollor afirmon idenë "Me fëmijën në qendër"e cila bazohet në disa parime më themelore: Fëmijët përfitojnë njohuri, zotërojnë shkathtësi dhe shprehi të ndryshme , fitojnë përjetime nga ndërveprimet me botën që i rrethon; Të rriturit (prindërit, edukatorët dhe të tjerët) nxisin rritjen dhe zhvillimin e gjithmbarshëm dhe aktiv të fëmijëve, duke vënë në bazë të punës mundësitë,interesat, nevojat dhe aftësitë e fëmijëve.

Filozofia "Me fëmijën në qendër" mundëson pra, krijimin e kushteve për zgjimin e mundësive dhe për zhvillimin e potencialeve individual të fëmijëve në mënyrë aktive dhe manifestimin kreativ e maksimal të tyre. Nga kjo rezulton se edukimi parashkollor duhet t`u mundësojë fëmijëve shprehjen dhe zhvillimin aktiv të nevojave, interesave

njohëse dhe të tjera, botës emocionale, aftësive të tyre, shkathtësive të ndryshme dhe shprehive të shëndosha.

Loja aktive është veprimatria më qenësore e fëmijëve të moshës parashkollore.Loja duhet t`u mundësojë fëmijëve t`i zhvillojnë aftësitë motorike e njohëse, pastaj duke bashkëvepruar me moshatrët,t`i kultivojnë shprehitë shoqërore dhe aftësitë sociale dhe, duke i zotëruar sfidat individuale e shoqërore, zhvillohen edhe në aspektin mendor, emocional dhe moral. Loja aktive dhe atraktive për fëmijën dhe grupin luan rol edhe në krijimin e atmosferes së përshtatshme për jetë të shëndoshë të fëmijëve parashkollorë, bashkëveprimin social.

Filozofia e edukimit parashkollor përshkohet me frymë demokratike dhe humane. Afirmon zhvillimin e lirë dhe emancipimin socio-kulturor të secilit fëmijë në çdo mjedis social në të cilin jeton fëmija.Kjo filozofi është e hapur për analizën, zgjedhjen dhe jetësimin e strategjive alternative të edukimit parashkollor dhe mundëson fleksibilitet të veprimeve edukative të të rriturve (prindërve, edukatorëve dhe të tjerëve).

Filozofia e edukimit parashkollor afirmon domosodshmërinë e bashkëveprimit reciprok e të ngushtë të përbërësve brenda faktorëve edukativ(faktorëve brendapërbrenda familjes apo faktorëve brendapërbrënda Institucionit parashkollor) dhe ndërmjet faktorëve të ndryshëm, por gjithnjë duke i respektuar specifikat e edukatës familjare.

Fëmija dhe të rriturit duhet të kuptojnë se të nxënit është proces shumë kahor, gjatë të cilit fëmijët mësojnë nga njeri tjetri, mësojnë nga të rriturit, por edhe të rriturit mësojnë nga fëmijët.Ka, pra rrugë të ndryshme për t`u arritur një qëllim, dhe pikërisht për këtë duhet, jo të ju imponohen fëmijëve idetë apo zgjidhjet , por të inkurajohen të provojnë, të bëjnë diçka të re, dhe idetë e përvojë e tyre t`i këmbejnë me të tjerët.

Një segment i pashmangshëm i Filozofisë së edukimit parashkollor është mbështetja –përforcimi pozitiv i fëmijës, që nënkupton të qendërzuarit në sjelljet e mira dhe tiparet pozitive të fëmijës, që si rrjedhojë ka dëshirën dhe angazhimin e fëmijës të bëhet i mirë

Filozofia e Edukimit parashkollor synon inkurajimin e zhvillimit tërësorë të personalitetit të fëmijës, të nevojshëm për fëmijën që të sfidohet dhe t`i sfidojë ndryshimet të cilat sot zhvillohen me shpejtësi.

## II. PARIMET E EDUKIMIT PARASHKOLLOR

- Edukimi parashkollor i institucionalizuar është hallka e parë e sistemit arsimor dhe realizohet në Institucionet parashkollore.

- Institucionet parashkollore realizojnë edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve parashkollor

- Institucionet parashkollore realizojnë veprimatrinë e tyre në bashkëveprim me familjen, komunitetin dhe institucionet përgjegjëse.

- Partneriteti i Familjes, Institucioneve parashkollore dhe Komunitetit siguron harmonizimin dhe vazhdimsinë e edukimit të fëmijës (Parimi i kontinuitetit horizontal).

- Institucioni parashkollor veprimatrinë edukative e mbështetë në përvojën dhe kontekstin familjar të fëmijës.

- Veprimtaria edukative nuk ndahet prerazi në grupmosha, por realizohet në vazhdimsi graduale e të natyrshme nga grupmosha në grupmoshë (Parimi i kontinuitetit vertikal).

- Në qendër të veprimatarisë edukative të Institucioneve parashkollore është fëmija me individualitetin (mundësitë, nevojat, interesat etj. ) dhe intimitetin e tij.

- Fushat e aktiviteteteve, për çdo grupmoshë, janë të integruara- të ndërlidhura dhe synojnë realizimin e qëllimeve të përbashkëta të edukimit parashkollor.

- Fëmija parashkollor mëson, aftësohet e shkathtësohet përmes përmbajtjeve të strukturuar.

- Fëmija parashkollor mëson, aftësohet e shkathtësohet edhe përmes jetës bashkëvepruese në Institucion parashkollor

- Loja është veprimtari qenësore përmes së cilës realizohet edukatimi i institucionalizuar parashkollor i fëmijës.

- Edukimi parashkollor i institucionalizuar veprimatrinë edukative e mbështetë dhe e realizon edhe mbi situatat e natyrshme jetësore të fëmijës.

- Institucionet parashkollore janë demokratike, ofrojnë shanse të barabarta të edukimit për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga përkatësia gjinore, etnike, fetare, racore etj.

- Institucionet parashkollore janë të hapura dhe sigurojnë edukim edhe për fëmijët me nevoja të veçanta (me aftësi të kufizuara).

- Familja- prindërit duke respektuar edhe dëshirat dhe nevojat e mundëshme të fëmijës zgjedhin Programin edukativ për fëmijën e tyre.

- Familja-prindërit , në bazë të mundësive, interesimeve , nevojave apo afiniteteve të fëmijës, zgjedhin llojet e aktiviteteve të preferuara për fëmijën e tyre.

- Në Institucionet parashkollore edukator/ja-i gëzon lirinë pedagogjike dhe përmbushë përgjegjësinë pedagogjike të nevojshme për zhvillimin e veprimatrisë edukate,në përshtatje me nivelin e zhvillimit të fëmijëve parashkollor.

- Institucionet parashkollore zhvillojnë veprimatari edukative të programuar që mund të realizohet përmes metodologjive të ndryshme bashkëkohore.

- Institucioni parashkollor është fleksibil, i hapur dhe i gatshme për ndryshime të favorshme për edukimin e fëmijëve parashkollor.

## III. QËLLIMET E EDUKIMIT PARASHKOLLOR

- Zhvillimi  tërësore i personalitetit të fëmjës, potencialit dhe shfaqjes maksimale të aftësive të tij.

- Zhvillimi dhe formësimi i individit të lire, të përgjegjshëm, aktiv e ndërveprues.

- Zotërimi i aftësive dhe kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese e ndërvepruese.

- Zhvillimi dhe përvetësimi i aftësive njohëse, afektive –emocionale,  shoqërore, morale dhe psikomotore.

- Respektimi i barazisë së shanseve edukative për të gjithë fëmijë.

- Fëmija i lumtur, i aftë për t`u përballur me sfidat e jetës.

IV. FUSHAT E AKTIVITETIT:

IV. I. EDUKIMI  FIZIK DHE SHËNDETI

IV. II.GJUHA AMTARE

IV. III. EDUKIMI ARTISTIK
- IV. III/1 EDUKIMI MUZIKOR
- IV.III /2 EDUKIMI FIGURATIV

IV.IV. HAPSIRA, RREGULLAT DHE PËRMASAT (MATEMATIKA)

IV.V.  NJOHJA E VETËS DHE BOTËS

## IV. FUSHA E AKTIVITETIT:

### IV. I. EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETI

## IV.I. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME GRUP MOSHA 3 – 6

1. Të arrijë mirërritjen, zhvillimin maksimal, rezistueshmërinë e organizmit dhe shëndetin.

2. Të zotërojë lëvizjet elementare motorike, aftësitë e përgjithshme për lëvizje dhe aftësitë shprehëse trupore dhe aftësive specifike elementare për lëvizje.

3. Të plotësojë nevojën për lëvizje e në funksion të aktivitetetve të ndryshme (loja, aktivitetetet figurative, muzikore etj.)

4. Të aftësohet të bashkëpunojë për t`i parandaluar apo tejkaluar pengesat dhe çrregullimet individuale në rritje dhe zhvillim.

5. Të zhvillojë aftësitë motorike, senzoromotorike dhe psikomotorike.

6. Të arrijë njohuri, shkathtësi dhe shprehi për higjienën personale, higjienën e ushqimit dhe të mjedisit jetësor dhe të kuptuarit e rëndësisë së shëndetit dhe kulturës fizike.

7. Të zhvillojë shkathtësitë për aplikimin e mjeteve dhe masave të domosdoshme për zhvillimin fizik dhe ruajtjen e shëndetit.

8. Të shfrytëzojë aktivitete fizike si përmbjatje-mjete për pushim të drejtë të fëmijës pas aktiviteteteve mendore e trupore të tij.

9. Të arrijë inkurajimin e zhvillimit etiko-morale dhe estetik përmes edukimit fizik

10. Të zhvillohet në sferën afektive (emociont, ndjenjat, interesat etj.)

11. Të pavarësohet në jetësimin e shkathtësive dhe shprehive të dobishme për fizikun dhe shëndetin e tij.

12. Të vetëdijësohet për mirërritjen dhe mirëqenien personale.

13. Të synojë përparimin në edukimin fizik e shëndetësor.

14. Të arrihet përparimi i duhura në procesin e edukimit fizik e shëndetësor të fëmijës parashkollor.

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të nisë koordinimi i harmonisë së lëvizjeve të tërë trupit, duarve dhe këmbëve, drejtpeshimi.<br><br>2. Të fillojë koordinimi i lëvizjeve me elementet e kohës, ritmit dhe hapsirës.<br><br>3. Të zhvillojë i shkathtësitë psiko-motore të krahërorit, duarve, shuplakave dhe gishtërinjëve të dorës.<br><br>4. Të zhvillojë i fuqi fizike, saktësi e lëvizjeve, shpejtësi e lëvizjeve, dëshirën për qëndrueshmëri fizike.<br><br>5. Të realizojë lëvizje të natyrshme më të thjeshta e gradualisht kah ato më të përbëra (ecja, vrapimi, kërcimi, rrokullisja, zvarritja, ngjitja, zbritja etj.)<br><br>6. Të nisë të përvetësojë koncepte elementare për lëvizjet (pozita në hapsirë).<br><br>7. Të njohë pozitën e trupit dhe marrëdhënie midis pjesëve të trupit.<br><br>8. Të njohë pozitën e trupit në raport me njerëzit e tjerë.<br><br>9. Të njohë pozitën e trupit në realcion me objektetet e caktuara | Bënë lëvizje të zakonshme (të natyrëshme) si : Ecje, vrapim, kërcim, zvarritje, hedhje, kapje, ngjitje, zbritje, rrokullisje, përshtrim,bartje, etj.<br><br>Bënë në ambiente të përshtatëshme për zhvillimin trupor dhe shëndetin e tij (në natyrë, në sipërfaqe të reilefit të ndryshëm, në ambiente të mbyllura të ajrosura).<br><br>Bënë aktivitete lëvizëse përmes: paisjeve të ndryshme (shkopi, top, litarë etj.) dhe<br>materiale të ndryshme (rrëra, uji, guralecat, letra,plastelina etj.)<br><br>Bënë aktivitete për lëvizjet e tërë trupit, gjumtyrëve krahut të dorës,shuplakës dhe gështërijtë e dorës , shputës etj.<br><br>Luan dhe realizon aktivitete si: mbushje, derdhje, shtupje, prekje, nivelizim, matje, balansim, drejtëpëshim etj.<br><br>Zhvillon aktivite të ecjes :<br>qëndrimi në këmbë.<br>qëndrimi me një këmbë,<br>ecje nëpër një vij të drejtë apo zik –zake etj.<br>ecje në vijë të lakuar dhe rrethore, | Tregon koordinim të lëvizjeve të tërë trupit, duarve dhe këmbëve, drejtpeshim.<br><br>Bënë koordinimin fillestar të lëvizjeve me elementet e kohës, ritmit dhe hapsirës.<br><br>Manifeston shkathtësitë psiko-motore të krahrorit, duarve, shuplakave dhe gishtrinjëve të dorës.<br><br>Vërehet zhvillimi i fuqisë fizike,nisma e saktësisë së lëvizjeve, shpejtësisë së lëvizjeve dhe manifestohet dëshira qëndruaeshmëri fizike.<br><br>Realizon ,gradualisht, lëvizjet e natyrshme si ecja, vrapimi, kërcimi, rrokullisja, zvarritja, ngjitja, zbritja etj.<br><br>Përvetëson konceptet elementare për lëvizjet dhe pozitën ashtu që njihen pozitat e trupit dhe marrëdhënjet ndërmjet pjesëve të trupit, pozitat e trupit në realcion me njerëzit e tjerë, pozitat së trupit në realcion me objektet e caktuara |

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 10. Të njoh dhe të realizoj lojërat lëvizëse elementare të ndryshme<br><br>11. Të përvetësojë mënyrat elementare të lëvizjeve me top<br><br>12. Të orvatjet për gjetjen e mënyrës personale për zgjidhjen e problemeve lëvizore<br><br>13. Të bëjë lëvizjet e para të lira në ujë dhe nisma e përvetësimit të elementeve themelore të notit<br><br>14. Të njihett dhe merret me aktivitete fizike dimërore si: ecja në bore, luajtja me bore, rrëshqitja me këmb, me sajë etj.<br><br>15. Të përvetësojë i elementet e lojrave dhe vallëzimeve popullore nga konteksti jetësor i fëmijës<br><br>16. Të njihet me lojrat elementare dhe sportet e ndryshme të mjedisit jetësor të fëmijës dhe mjediseve e kulturave të tjera, nga e kaluara dhe sot<br><br>17. Të inkuadrohet dhe të aftësohet për lojrat me rregulla.<br><br>18. Të aftësohet për bashkëveprim në lojrat grupore apo në qifte dhe kultivimi i sjelljeve elementare sportive.<br><br>19. Të njihet me pajisjet elementare sportive, t'i emëroj dhe të shkathtësohet për përdorimin e tyre në aktivitetet fizike. | • **Aktivitete të ecjes:**<br>- Ecje nëpër koridore të caktuara, ecje në çifte dhe në rradhë,<br>-Ecje nëpër shkallë të ulëta.<br>- Ecje këmba dorës,ecje mace,,<br>- Ecje ndërmjet dhe midis objekteve etj.<br><br>• **Aktivitete të drejtëpeshimit-balansimit:**<br>-lojra me paisje si : hulaja, drasa me federa**.(shih, materialin e ekspertëve).**<br><br>• **Lojërat me përmbajtje :**<br>-mëshefje,<br>- ndjekje etj<br><br>Vrapime me grupe të cilat organizohen me dhe pa rekuizita<br><br>• **Lojërat imitative:**<br>-imitimi i shtazëve,shpendëve ;<br>- imitimi i njërëzve dhe mjeteve mekanike;<br>imitimi i ca dukurive natyrore të shoqëruara me lëvizje ritmike;<br>- imitimi i ca manireve shoqërore të përcjellura me ritëm si:rrahja e shuplakave,hapi ritmik,përulja e tij, lëvizjet e trupit etj.<br><br>• **Aktivitete me top:**<br>-hudhja;<br>-kapja<br>-mbajtja;goditja etj.<br>• **Luajnë me top e balona me madhësi . peshë, ngjyrë dhe mateiale të ndryshme.** | Arrijë njohjet elementare dhe realizimet e para të lojrave lëvizore elementare<br><br>Tregon tendencat për zgjidhjen personale të problemeve lëvizore.<br><br>Përvetëson mënyrat elementare të lëvizjeve me top<br><br>Arrin lëvizjet e para të lira në ujë dhe përvetëson elementet themelore të notit<br><br>Njeh dhe merret me aktivitete fizike dimërore, ecë në bore, luan me bore, rrëshqet në këmb, me sajë etj.<br><br>Përvetëson elementet e para të lojrave dhe vallëzimeve popullore nga konteksti i tij jetësor<br><br>Njeh disa lojra elemntare dhe sporte të mjedisit të vet dhe të mjediseve e kulturave të tjera, nga e kaluara dhe sot<br><br>Nisë të inkuadrohet në lojrat me regulla<br><br>Fillon të bashkëveprojë gjatë lojrave grupore dhe tregon shenjat e para të sjelljes sportive<br><br>Njeh, emërton dhe përdor paisjet elementare sportive |

**GRUP-MOSHA 3-4**

| **OBJEKTIVAT E VEÇANTA** | **AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS** | **REZULTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| 20. Të përvetësojë njohurit e para higjienike dhe njohja me veshjen e përshtatshme për aktivitete fizike<br><br>21. Të fillojë vetëdijësimi për rolin e natyrës dhe ambientit të pastër për zhvillimin fizik dhe shëndetin e fëmijës<br><br>22. Të aftesohet në njohjen elementare te masat e sigurisë dhe te nise aftësimit për aplikimin e tyre për ruajtjen e shëndetit personal | • **Aktivitete me ujë:**<br>-loja me ujë;<br>-loja në ujë, me dhe pa rekuizita;<br>-noti i lirë;<br><br>• **Aktivitetet në borë:**<br>-lojëra të lira në borë dhe me borë;<br>-rrëshqitje në sipërfaqe të ndryshme të borës me saja, me ski si dhe me mjete të tjera të cillat janë të përshtatëshme për fëmijën<br><br>• **Aktivitetet e ngasje në sipërfaqe të rrafshta dhe me relefe:**<br>-ngasje me karrocë;<br>- biçikletë- triçikletë;<br>- trotinet;<br>- automobile për fëmijë; | Ka njohuri elementare higjienike dhe njeh veshjen e përshtatshme për aktivitet fizik<br><br>Ruan natyrën dhe ambientin jetësor si shenja të para të vetëdijësimit<br><br>Njeh, kupton dhe aplikon masat themelore të sigurisë së shëndetit dhe fizikut |

## GRUP-MOSHA 4-5

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të zotërojë lëvizjet bazike motorike.<br><br>2. Të përforcojë zhvillimin e aftësive të veçanta psikomotorike.<br><br>3. Të zhvillojë aftësitë për lëvizje të koordinuara dhe harmonike të tërë trupit, në harmoni me kohën, ritmin dhe hapsirën.<br><br>4.. Të zhvillojë shkathëtësitë psiko-motore të muskujve të mëdhenjë dhe të imët(fine).<br><br>5. Të aftësohet në mbajtjen e drejtë të trupit dhe të drejtpeshimit. | • **Aktivitetin e ecjes:**<br>Ecje në kolonë në një vijë të drejtë; ecje mbi maje të gishtërinjve; ecje këmbadoras, ecje sipas vijave dhe figurave; ecje këmbadoras me zvarritje; ecja me hapa të gjata dhe të shkurta. ecje ngadalë dhe shpejtë; ecja pa zhurmë(si macja); ecja para, prapa dhe anash; ecja në terren të rrafshët dhe jo të rrafshët. ecja mbi tra të ulët, bangë dhe dërrasë. ecja dhe bartja e vegëlzave (të topit, rrethit, shkopit, etj.).<br>• **Aktivitete vrapimi**<br>Vrapimi i lirë, vrapimi me hapa të gjatë dhe të shkurtër; Vrapimi me ritëm të ngadalësuar, mesatar dhe të shpejtë; Vrapimi ndërmjet pengesave, kapërcimi i pengesave duke vrapuar; Vrapime në drejtime: para, drejt, prapa, lakore, rrethore. Vrapimi një nga një,në dyshe,njëri pas tjetrit,në grup,etj. Lojëra elementare lëvizore (me vrapime).<br>• **Aktivitete të kërcimit:**<br>Kërcimet pupthi me dy këmbë: në vend, para, prapa, majtas dhe djathtas, kërcimthet me një këmbë: në vend, para, prapa, majtas dhe djathtas. **K**ërcime nga lartë-poshtë në thellësi. | Më me sukses koordinon lëvizjet e tërë trupit me gjymtyrët dhe arrinë drejtpeshim më të lartë<br><br>Bënë koordinimin më të suksesshëm të lëvizjeve me elementetet e kohës, ritmit dhe hapsirës<br><br>Tregon shkathtësi psiko-motore të krahërorit, duarve, shuplakave dhe gishtërinjëve të dorës dhe pjesëve të tjera të trupit<br><br>Manifeston fuqi, qëndrueshmëri dhe rezistencë më të madhe fizike, saktësi, precizitet dhe shpjetësi më të madhe të lëvizjeve<br><br>Bënë lëvizje të natyrshme të thjeshta dhe më të përbëra (ecje, vrapim, kërcim, rrokullisje, zvarritje, ngjitje, zbritje etj.)<br><br>Ka koncepte elementare për lëvizjet (pozita në hapsirë):<br><br>Njeh pozitën e trupit dhe marrëdhënien ndërmjet pjesëve të trupit<br><br>Njeh pozitën e trupit në raport me njerëzit e tjerë |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 6. Të zhvillojë sistemin respirator dhe kardiovaskular.<br><br>7. Të vetëdijësohet për dobinë e aktivitetit për shëndetin<br><br>8. Të rritë rezistencën fizike dhe shëndetësore dhe akomodimi në kushtet e ndryshme atmosferike<br><br>9. Të zhvillojë përjetime të këndëshme dhe të motivohet për pjesëmarje në aktivitete fizike.<br><br>10. Të zhvillojë dhe të përvetësojë nocionet elementare në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor emërtimin i veglave dhe rekuizitave fizike. | Kërcim së gjati nga vendi, kërcim së larti nga vendi. Kërcim së gjati me vrull, kërcim së larti me vrull. Kërcimthet para, anash dhe prapa; ecjet në gishtërinj të këmbëve mbi rekuizita(trar, bankë, mbi litar, në tokë,etj.<br>• **Aktivitete te ngjitjes dhe te zbritjes:**<br>Ngjitja vetëm me këmbë ( në shkallë). Ngjitja me këmbë dhe duar: ngjitja dhe zbritja në shpatullore, në bankë të pjerrët, në shkallë vertikale,në arkë suedeze, mbi urë, etj.<br>• **Aktivitete te zvarritjes**<br>Zvarritjet barkas, injësh dhe në shpinë me lëvizjen e duarëve dhe të këmbëve;<br>Zvarritjet dhe përshkimet bëhen: para, drejt, me leqe, ndërmjet rekuizitave dhe nën rekuizita.<br>Zvarritjet në dysheme,në bankë, tra, dërrasë etj.<br>Zvarritje midis korridoreve të caktuara, midis objekteve(rekuizitave) mbi vijë të drejtë, mbi tra të ulët.<br>Zvarritje mbi tra me rekuizita (top shkop,rreth, etj. )<br>• **Aktivitete te hedhjes:**<br>Hedhje me një dhe me dy duar, me hove;<br>hedhje nga poshtë, nga lartë dhe anash.<br>hedhje në gjatësi, lartësi dhe në cak; | Njeh pozitën e trupit në relacion me objektet e caktuara<br><br>Njeh dhe realizon lojërat lëvizëse elementare të ndryshme<br><br>Bënë lëvizje të ndryshme me top.<br><br>Përpiqet për të gjetur mënyrën personale për zgjidhjen e problemeve të lëvizjes<br><br>Lëvizë lirëshëm në ujë dhe demonstron elementet themelore të notit<br><br>Njeh dhe merret me aktivitetet fizike dimërore – ecë në bore, luan me bore, rrëshqet me këmb, me sajë etj.<br><br>Luan elementet e lojrave dhe vallëzimeve popullore nga konteksti jetësor i tij<br><br>Njeh lojrat elementare dhe sportet e ndryshme nga mjedisi jetësor, mjediset e kulturave të tjera, nga e kaluara dhe sot<br><br>Luan lojrat me rregulla<br><br>Bashkëvepron dhe tregon sjellje sportive elementare në lojrat grupore apo në qifte. |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| **OBJEKTIVAT E VEÇANTA** | **AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS** | **REZULTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| 11. Të shkathtësohet për aplikimin e veglave dhe rekuizitave.<br><br>12. Të njoh dhe aplikojë rregullat elementare gjatë realizimit të lëvizjeve motorike. | hedhja e topit, topthave, topthatë me rërë, shkoptha, etj.<br>• **Aktivitete e ngritjes dhe bartjes:**<br>Ngritja dhe bartja e medicinballit.<br>Ngritja dhe barta e më shumë rekuizita-ve (topa, toptha, rrathë, qese me rërë,etj.);<br>ngritja dhe bartja e veglave (trari, banga, tavolina, dysheku, medicinballit etj.<br>nga pozita në këmbë dhe në gjunjë;<br>ngrite dhe bartë me krahë lart- - poshtë, para-lart, djathtas-majtas, pa dhe me mjete(shkopinj,rrathë,topa, shishe druri, litarë), etj.<br>• **Aktivitete në borë:**<br>Lojëra të ndryshme në borë(gjuajtja me toptha bore, formimi i figurave, etj.).<br>Rrëshqitja me sajë,ecje dhe vrapimi në borë.<br>• **Aktivitete e ngasjes:**<br>Ngasja e triçikletës dhe trotinetit në terrene të rrafshta<br>• **Aktiviteti i ecjes:**<br>**Ecje** në vijë të drejtë, ecje mbi maje të gishtërinjëve me duar të ngritura anash, ecje këmba- doras; ecja sipas vijave dhe figurave, ecja këmbadoras me zvarritje, ecje me hapa të gjata dhe të shkurtëra, ecja ngadalë dhe shpejtë, ecje para, prapa dhe anash, ecje në terren të rrafshët dhe jo të rrafshët;<br>ecje mbi tra të ulët, bangë dhe dërrasë, ecja dhe bartja e vegël-zave (topi, shkopi, rrethi,etj.), ecje (marshimi) | Njeh dhe emërton paisjet sportive dhe tregon shklathtësi elementare gjatë përdorimit të tyre.<br><br>Përvetëson njohuri dhe shprehi higjienike, njeh veshjen e përshtatshme për aktivitet fizik.<br><br>Kupton rolin e natyrës dhe ambinetit të pastër për shëndetin dhe gjendjen fizike dhe kultivon natyrën dhe mirëmbanë ambientin jetësor.<br><br>Njeh dhe i aplikon gradualisht masat e sigurisë dhe ruajtes së shëndetit. |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të vazhdojë t'i zhvilloj aftësitë psikomotore.<br><br>2. Të krijojë dhe pasuroj shprehitë për lëvizje në funksion të rritës dhe mbrojtjes së shëndetit.<br><br>3. Të forcojë shprehitë për mbajtjen e drejtë të trupit dhe drejtpeshimin.<br><br>4. Të zhvillojë ndieshmërinë për koordinimin dhe harmoninë e lëvizjeve të trupit sipas ritmit,intervaleve kohore dhe hapsirësë.<br><br>5. Të përforcojë mëtej shkathtësitë e muskujve të mëdhejë dhe të imët (fine). | Ecje në gishtërinjë të këmbëve mbi rekuizita: në tokë, tra, bangë,mbi litar etj.<br>• **Aktivitete vrapimi:**<br>Vrapimi me ritëm të ngadalsuar, mesatar dhe të shpejtë; vrapimi ndërmjet pengesave, shishe druri, medicinball topa, etj. vrapim me shpejtësi; vrapim me kërcim pengesash; vrapim me shpejtësi; vrapim duke e rrokullisur rrethin; vrapim dhe kërcimthe me ritëm të rregullt; vrapim dy nga dy me duar të kapur; lojra elementare lëvizore me vrapim.<br>• **Aktivitetet e kercimit:**<br>Kërcime pupthi me dy këmbë në vend, para, prapa, majtas, djathtas; kërcimthet me një këmbë para, prapa dhe anash; kërcim së larti nga vendi; kërcim së gjati nga vendi; kërcim së larti me vrull; kërcim së gjati me vrull; lojëra elementare me kërcime; kapërcimi i prockës; kërcime me litar etj.<br>• **Aktivitete e ngjitjes:**<br>Ngjitja vetëm me këmbë; ngjitje e zbritje në shkallë vertikale me këmbë dhe duar; ngjitja dhe zbritja në shpatullore; ngjitja dhe zbritja në bangë të pjerrët. Ngjitja dhe zbritja në shkallë vertikale.<br>• **Aktivitetet e zvarritjes:**<br>Zvarritja barkas, injësh dhe në shpinë me veprim të duarve dhe të këmbëve; zvaritja para me leqe, ndërmjet rekuizitave, nën rekuizita (bangë,litar, rreth, arkë, unaza e arkës, etj.); zvarritja dhe përshkimi në dysheme, në bangë, tra, etj; zvarritja midis rekuizitave,mbi vijë të drejtë, mbi tra të ulët; | Demonstron harmoni më të lartë të lëvizjeve të tërë trupit, duarve, këmbëve dhe drejtpeshim.<br>Bënë koordinim më të harmonishëm të lëvizjeve me elementet e kohës, ritmit dhe hapsirës<br>Demonstron shkathtësi psiko-motore më të madhe të krahërorit, duarve, shuplakave dhe gishtërinjëve të dorës dhe të pjesëve të tjera të trupit<br>Bënë lëvizje më të shakta, precise dhe më të shpejta , demonstron fuqi më të madhe fizike, qëndrueshmëri dhe rezistencë<br>Bënë lëvizje të natyrshme të thjeshta dhe lëvizje më të përbëra (ecja, vrapimi, kërcimi, rrokullisja, zvarritja, ngjitje, zbritje, hudhje, kapje etj.)<br>Njeh relacionet e trupit me trupat e tjerë në hapsirë<br>Njeh pozitën e trupit dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëve të trupit<br>Njeh pozitën e trupit në relacion me njerëzit e tjerë.<br>Njeh pozitën e trupit në relacion me objektet e caktuara<br>Njeh dhe realizon lojëra lëvizëse elementare të ndryshme<br>Njeh mënyrat më komplekse të lëvizjeve me top dhe rekuizita të tjera |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 6. Të zhvillojë më tej sistemin respirator dhe kardiovaskular.<br><br>7. Të thellojë vetëdijen për rolin e aktivitetit fizik për shëndetin.<br><br>8. Të bëhet i rezistueshëm dhe të akomodohet në kushte të ndryshme atmosferike.<br><br>9. Të zhvillojë motivacionin e brendshëm për aktivitete fizike.<br><br>10. Të zhvillojë sensit dhe kënaqësisë për aktivitetet fizike si dhe manifestimin e tyre. | Zvarritja para mbi tra të ulët. zvarritja mbi tra me krah të ngritur anash; duke bajtur rekuizita, (shkop, top, rreth,etj.); zvarritja anash mbi tra.<br>• **Aktivitetet e hedhjes:**<br>Hedhjet me një dhe dy dyar; hedhjet nga poshtë, nga lartë dhe anash; hedhja në gjatësi, lartësi dhe në cak. Hedhjet top, topthi, shkopi, topthi i mbushur me rërë,etj. Hedhje e topit në distanca të ndryshme.<br>• **Aktiviteti i ngritjes dhe bartjes**<br>Ngritja e bartja e medicinballit; Ngritja e bartja e më shumë vegëlzave (topa, rrathë, shishe druri,etj.); ngritja dhe bartja në grupe(trari,banga, tavolina, shkalla, dysheku,etj.<br>Ngritja dhe bartja në pozita ulur, në këmbë, dhe shtrirë barkas. Bartja me krah lartë-poshtë, para-lartë, anash pa dhe me rekuizita shkop, top, rreth, shishe druri.<br>Ngritja dhe bartja nga pozita: në këmbë, ulur dhe shtrirë në shpinë; ngritja e gjurit, gjunjëve dhe këm-bëve; ngritja e trupit nga pozita shtrirë në shpinë; ngrtitja me ndihmën e duarëve në pozitën ulur.<br>• **Aktivitete në ujë**<br>Lojra të ndryshme në ujë të cekët, ecja në ujë.Veprimi me këmbë dhe duar në ujë, pluskimi dhe rrëshqitja në ujë.<br>• **Aktivitetet në borë**<br>Lojëra elementare në borë: gjuajtja me toptha bore, formimi i figurave etj; rrëshqitja dhe tërheqja me sajë në çifte. | Demonstron zgjidhjen e mënyrës personale të problemeve të lëvizjeve<br>Lëvizë lirshëm në ujë dhe noton (demonstron shkathtësi elementare të notit)<br>Njeh dhe merret me aktivitetet fizike dimërore-ecë në, luan me bore, rrëshqet me këmb, me sajë, me ski etj.<br>Luan dhe vallëzon valle popullore nga konteksti jetësor i tij<br>Njeh lojrat dhe sportet e ndryshme të mjedisit jetësor dhe mjediseve e kulturave të tjera, nga e kaluara dhe sot.<br>Luan lojrat me rregulla dhe respekton rregullat e lojës.<br>Bashkëvepron në lojrat grupore apo në qifte dhe manifeston sjellje sportive si dhe vetfrenim<br>Ka njohuri më të gjera për paisjet sportive dhe shkathtësi të duhura për përdorimin e tyre në aktivitetet fizike.<br>Ka njohuri e shprehi higjienike dhe pavarësi gjatë veprimeve hiogjienike<br>Veshmbathet pavarësisht<br>Njeh veshjet e përshtatshme për aktivitete fizik<br>Vetshërbehet gjatë ngrënies |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 11. Të pasurojë fjalorin dhe të shkathtësohet për përvetësimin e aplikimin e rregullave të aktiviteteve fizike. | Ecjet dhe vrapimet në borë në formë të lojërave.<br>• **Aktivitetet e ngasjes**<br>Ngasja e triçikletës, trotinetit dhe biçikletës në terren të rrafshët-asfalt. Ngasja e biçikletës me ndihmë. | Kupton rolin e natyrës dhe ambientit të pastër për shëndetin dhe zhvillimin fizik, kultivon dhe e ruan natyrën, mban higjienën dhe rregullin e ambinetit jetësorë.<br>Njeh masat e sigurisë së ambinetit jetësorë dhe shëndetit dhe i aplikon ato |

## IV.I. 11. Integrimi ndërfushorë

Aktivitetet e edukimit fizik ndërlidhen me fushat e tjera edukative.
Gjatë aktiviteteve fizike dhe shëndetësore me fëmijët bisedohet për ndryshimet që ndodhen në trupin e tyre dhe, gjendjen e tyre fiziologjike (lodhjën, skuqëjën, ndjersitjen, rrahja e zemërës frymarjen e shpejtuar etj.)

Bisedohet për shkakun e këtyre ndryshimeve dhe për rëndësinë e ndikimit të këtyre aktiviteteve në forëcimin e trupit e të shëndetit.

Gjatë aktiviteteve fizike e shëndetësore komunikojmë duke përdorur shprehje e fjalë si:përpara,prapa.përkrah,ndëemjet,shpejtë,ngadalë,drejtë,me këthesa,cik-zak,rreth,nën,mbi,në, nëpër, afër, largë, shkurtë, gjatë, mesatarë, djathtas, majtas, lartë, poshtë etj.

Qëndrimi në mjedise të jashtme në natyrë ofron mundësi për perceptimin e kushteve klimatike, kronologjike e atmosferike (ngrohtë, ftoht, lagështi, furtunë, puhi, sot, nesër, mëngjez, paradite, pasdite,etj.)

Bisedohet për rëndësinë e faktorëve klimatik në funksion të ruajtjes së shëndetit dhe mënyrës së veshjes gjatë ndryshimeve klimatike.

Aktivitetet fizike ndërlidhen edhe me të gjitha format e shprehjes estetike.Gjatë lojrave ritmike fëmijët shoqërohen me këngë, muzikë dhe harmoni.(vallëzimi, baleti patinazhi etj.)

Shprehja e lëvizjeve harmonike gjatë aktiviteteve fizike ndihmohet edhe me modelime e ilustrime të llojëllojëshme figurative.Fëmijët modelojnë, pikturojnë e vizatojnë trupa, figura, akcione, lëvizje të faculetave e trakave të gjatësive e ngjyrave të ndryshme etj. Kjo ndihmon jo vetëm në formimin e përfytyrimit për lëvizjen por edhe krijimin e përshtypjes pozitive për vetën e tij.

## IV.FUSHA E AKTIVITETIT:

### IV.II. GJUHË AMTARE

## IV.2. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME GRUP MOSHA 3 – 6

1. Të aftësohet të komunikojë me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, të shprehë mendimet, idetë, ndjenjat etj.

2. Të ushtrojë aftësinë e të folurit dhe të dëgjuarit

3. Të ketë mundësi të shumta të dëgjojë vjersha, përralla, tregime etj

4. Të realizojë aktivitetet muzikor me pjesmarrjen e fëmijëve

5. Të bëjë aktivitetete gjatë të cilave përdorë imagjinatën dhe ndjenë kënaqësi

6. Të bëjë aktivitetete që sigurojnë ushtrimin e lidhjes së tingullit me grafema

7. Të bëjë aktivitetete që i mundësojnë të lexojë dhe të shkruajë fjalët nga konteksti i përditshmërisë

8. Të shprehë interes e të aftësohet të përceptojë të shkruarit e të rriturve dhe të bëjë përpjekjet për të shkruar

9. Të zhvillojë aktivitete shtesë për përmirësimin apo zbutjen e vështirësive në të folur

10. Të bëjë përpjekje për përparimin e gjuhës së vet

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të zhvillojë aftësinë e të dëgjuarit në kuptimin e pranimit të informatave dhe mesazheve;<br><br>2. Të aftësohet në të dëgjuarit dhe përvetësimin e pasurimin e fjalorit me fjalë e shprehje të reja nga fushat e ndryshme të jetës;<br><br>3. Të zhvillojë të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës standarde, shqiptimin dhe drejtshqiptimin e tingujve, fjalëve, fjalive;<br>4. Të inkuadrohet në komunikim me moshatarët dhe të rriturit të tjerë (komunikim verbal, joverbal, kultura e komunikimit, stilet, mirësjellja);<br>5. Të zhvillojë të folurit në funksion të zgjerimit të leksikut përkatësisht pasurimit të fjalorit me fjalë dhe shprehje të reja;<br>6. Të zhvillojë të folurit joverbal përmes mimikës së veprimit dhe shikimit-gjuhen e trupit;<br>7. Të zhvillojë shkathtësinë për t"u përgjegjë në shprehjet joverbale të të tjerëve;<br>8. Të aftësohet për të shfrytëzuar gjuhën për funksione të ndryshme e në situate të ndryshme sociale gjatë aktiviteteve të ndryshme;<br>9. Të përjetojë komunikimin verbal si ndjenjë të këndshme,argëtim;<br>10. Të argëtohet me prallëza, vargje ritmike, recitime, të njeh librin si burim të përmbajtjeve; | • **Të dëgjuarit**<br>Dëgjon: përrallëza, përralla e tregime shumë të shkurtëra dhe lojëra didaktike;<br>Dëgjon dhe përvetëson : të shqiptuarit e tingujve zanor dhe bashkëtingëllor, rrokjeve dhe fjalëve;<br>Dëgjon dhe pasuron fjalorin me fjalë të reja, me shprehje të veçanta gjuhësore nga fusha të ndryshme të jetës.<br><br>• **Të folurit**<br>Gjatë të folurit shqiptonë drejtë: tingujt zanor dhe bashkëtingëllor ( sidomos: gj,xh, r,rr, s,sh, ç,q etj ) dhe lidhjen e tyre në rrokje;<br>Gjatë të folurit dhe komunikimit shqiptonë drejtë dhe me intonacion fjalët dhe fjalitë.<br>Gjatë të folurit aktiv, fëmija i këtsaj moshe, pasuronë fjalorin e tij me fjalë dhe shprehje të cilat lidhen me përditshmërinë në fushat e ndryshme të jetës;<br>Përsërit atë që ka dëgjuar nga edukatorja si: përrallëza, përralla, gjëegjëza, tregime të shkurtëra, vjersha, lojëra didaktike etj.<br>Ushtronë të folurit joverbal përmes shprehive e veçorive të ndjenjave emocionale; përmes mimikës së fytyrës, mimikës së veprimit ( gjestikulacioneve ) dhe shikimit. | Dëgjon në mënyrë aktive informata nga të tjerët;<br>Kupton prezantimet gojore;<br>Ka të zhvilluar ndjenjën e të dëgjuarit në grup;<br>Kupton tekste të thjeshta jo letrare e letrare ;<br>Dëgjon tinguj e fjalë të ndryshme ;<br><br>Të prezantoj veten;<br><br>Të përsëris atë që kanë dëgjuar ;<br><br>Të kuptoj të folurit në grup;<br><br>Shqipton drejtë tingujt dhe fjalët;<br><br>Tregon ndjeshmëri për komunikimin (mimikën shikimin etj) |

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 10. Të kultivojë ”leximi dhe shkrimi” i parashkollorit;<br><br>11. Të zhvillojë shprehje të pavarura nga tregimet,përrallëzat , ilustracionet,…etj. | • **Të lexuarit**<br>Shfletojnë librin, revistën, gazetën dhe dallojnë pjesën me fotografi dhe pjesën me shkronja;<br><br>Flet mbi bazën e ilustrimeve dhe fotografive;<br><br>Nga revistat, gazetat dhe materialet e ndryshme i pret fotografitë e figurat që lidhen me një tematikë të caktuar për të cilën bëhet fjalë; | Njeh dhe dallonë pjesën me fotografi ;<br><br>Të “lexojn” , ilustracionet, fotografitë dhe materiale të ndryshme me tekst; |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të vazhdojë të zhvillojë aftësit në të dëgjuarit në kuptimin e pranimit të informative dhe mesazheve;<br><br>2. Të ushtrojë aftësinë e të dëgjuarit aktiv për të kuptuar dhe vlerësuar të tjerët që flasin;<br><br>3. Te ushtrojë më tej të dëgjuarit e teksteve letrare dhe joletrare dhe identifikimi i tyre;<br><br>4. Të dëgjojë, përvetëoj e pasuroj fjalorin me fjalë e shprehje të reja nga fushat e ndryshme të jetës;<br><br>5. Të vazhdojë të zhvillojë të folurit në funksion të komunikimit të informacionit,mesazhit të caktuar;<br><br>6. Të intensifikohet të folurit aktiv në grup,prezantimet gojore dhe rregullat e komunikimit;<br><br>7. Të zhvillojë të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës standarde,shqiptimi dhe drejtshqiptimin e fjalive, fjalëve, tingujve;<br><br>8. Të zhvillojë të folurit në funksion të teksteve të thjeshta letrare dhe joletrare që lidhen me | • **Të dëgjuarit**<br>Dëgjon, merr dhe regjistron informata të ndryshme nga prindi, edukatorja, familja,mjedisi, etj.<br>Dëgjon prezantime gojore të moshatarëve dhe të rriturve për tema caktuara ( ngjarje, tregime të ndryshme, histori të shkurtëra etj. ).<br>Dëgjon aktivisht folësit dhe bashkëbiseduesit ;<br>Dëgjon tekste të zakonshme joletrare të karakterit ( si urime, falënderime, porosi, ftesa, letër e shkurtër etj) njohës, didaktik, dokumentar;<br>Dëgjon dhe identifikon format e thjeshta letrare: përrallëza, përralla, tregime e shkurtëra, vjersha të shkurtëra dhe lojëra didaktike.<br>Dëgjon dhe përpiqet të kupton se gjuha e folur është e organizuar në nivele të tingujve, fjalëve e fjalive ;<br>Gjatë prezantimeve të ndryshme, dëgjon dhe përvetëson : të shqiptuarit e tingujve zanor dhe bashkëtingëllor, rrokjeve dhe fjalëve; drejtshqiptimin dhe intonacionin.<br>Dëgjon dhe pasuron fjalorin me fjalë të reja, me shprehje të veçanta gjuhësore dhe me fjali nga fusha të ndryshme të jetës.<br>• **Të folurit**<br>Përmes akteve të të folurit prezantojnë veten, transmetojnë ose përcjellin një propozim, një kundërshtim, një deklarim, një porosi, një dëshirë në mënyrë të tillë që folësi i kësaj moshe të angazhon vetën dhe të tjerët në | Dëgjon dhe kupton informatat e mesazhet nga të tjerët;<br><br>Kupton prezantimet gojore<br><br>Ka te zhvilluar ndjenjat e të dëgjuarit në grup;<br><br>Kupton tekste të thjeshta joletrare e letrare ;<br><br>Dëgjon tinguj të ndryshëm, fjalë dhe në to të dallojnë rrokjet; |

| | | |
|---|---|---|
| botën dhe interesimet e tyre; | dëgjim dhe komunikim të mirë. | |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| **OBJEKTIVAT E VEÇANTA** | **AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS** | **REZULTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| 9. Të nxitet në zhvillimin e të folurit joverbal përmes mimikës së veprimit dhe shikimit;<br><br>10. Të zhvillojë dhe të aplikoj të folurit në funksion të teksteve të thjeshta letrare dhe jo letrare që lidhen me botën dhe interesimet e tij;<br><br>11. Të "lexojë" ilustrimet, fotografive,figurave,vizatimeve dhe objekteve me mbishkrime;<br><br>12. Të dëgjojë dhe të njihet me letërsi të kulturave të ndryshme;<br><br>13. Të vazhdojë të njihet me librin dhe të kuptojë librin si burim të informacioneve;<br><br>14. Të zhvillojë përjetimet dhe qëndrime të këndshme dhe mendim pozitiv për librin (ta do librin);<br><br>15. Të bënë orvatjet e para të krijimit letrarë dhe të përshkrimit e personazheve, ngjarjeve, situatave,…etj.;<br><br>16. Të zhvillojë aftësin për ti dalluar ndryshimet midis të folmes lokale (lokalizmave); | Bënë prezantime gojore për një temë të caktuar, diskutojnë në mënyrë aktive për atë që kanë dëgjuar, japin përgjigje në grup;<br>• **Të folurit në funksion gjuhësor**<br>Gjatë të folurit shqiptonë drejtë: tingujt zanor dhe bashkëtingëllor ( sidomos: gj,xh, r,rr, s,sh, ç,q etj ) dhe lidhjen e tyre në rrokje; ndarjen e fjalës në rrokje; kuptimin e fjalisë etj.<br>Gjatë të folurit dhe komunikimit shqiptonë drejtë dhe me intonacion fjalët dhe fjalitë.<br>Gjatë të folurit aktiv, fëmija i kësaj moshe, pasuronë fjalorin e tij me fjalë dhe shprehje të cilat lidhen me përditshmërinë në fushat e ndryshme të jetës.<br>• **Të folurit në funksion të teksteve letrare dhe joletrare**<br>Flet dhe parafrazonë tekste të thjeshta joletrare që lidhen me botën e tij dhe interesimet e tij;<br>Flet, parafrazonë e ritregonë, recitonë dhe luanë në role tekste letrare: përrallëza, përralla, gjëegjëza, tregime të shkurtëra, vjersha, pjesë dramatike etj.<br>• **Të folurit joverbal (jogojor )**<br>Të folurit joverbal përmes shprehive e veçorive të ndjenjave emocionale;<br>Përvetësimi i ndjenjës joverbale përmes mimikës së fytyrës, mimikës së veprimit ( gjestikulacioneve ) dhe shikimit. | Dinë të prezantojë veten, të propozojë, të kundërshtojë etj.;<br><br>Dinë të bëjë prezantime gojore për një temë të caktuar;<br><br>Kupton rëndësinë e të folurit në grup;<br><br>Shqipton drejtë tingujt, fjalët dhe fjalitë e thjeshta ;<br><br>Parafrazon, ritregonë dhe recitojnë tekste të thjeshta letrare dhe joletrare;<br><br>Ka ndjesi për komunikim joverbale për mes mimikës dhe shikimit. |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| **OBJEKTIVAT E VEÇANTA** | **AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS** | **REZULTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| 17. Të aftësohet për të bërë dallimin midis gjuhës letrare dhe të folmes së të tij në raste konkrete;<br><br>18. Të dëgjojë dhe shikoj përmbajtje nga kultura e mjedisit të vet dhe të kulturave të tjera për mjete audiovizuele;<br><br>19. Të aftësohet në shkathtësinë e të treguarit dhe përpunimit të tregimeve të ndryshme nga jeta-krijon "libërth";<br><br>20. Të vetëdijesohet që bisedat gojore mundë të shkruhen e të njëjtat të lexohen.;<br><br>21. Të zhvillojë komunikimin e ideve përmes lojës me role,teatrit të kukullave,dramatizimit..etj.;<br><br>22. Të zhvillojë aftësinë dhe guximin për ti manifestuar synimet, përshkruar dhe shprehur mendimet e veprimet ,që kanë dashur dhe i kanë bërë;<br><br>23. Të bisedojë për krijimet e bëra dhe i vlerësonë ato. | • **Të lexuarit**<br>**Njohja me tekste të shkruara**<br>Shfletonë librin, revistën, gazetën dhe dallojnë pjesën me fotografi dhe pjesën me shkronja;<br><br>Flet përkatësisht i "lexonë" ilustrimet, fotografitë që paraqesin objekte, figura dhe gjëra tjera të njohura dhe të panjohura për moshën e tyre;<br><br>Nga revistat, gazetat dhe materialet e ndryshme presin fotografitë e figurat që lidhen me një tematikë të caktuar për të cilën bëhet fjalë;<br><br>"Lexonë" urdhëra, ndalesa dhe vërejtje të vizatuara apo të shtypura ( p.sh. shenjat e komunikacionit ); | Njoh dhe dallon pjesën me fotografi dhe pjesën e shkruar;<br><br>"Lexon" ilustrimet, fotografitë dhe objektet e ndryshme;<br><br>"Lexon" përmes shenjave ndalesa, vërejtje, urdhëresa etj. |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| **OBJEKTIVAT E VEÇANTA** | **AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS** | **REZULTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| 24. Të shkathtësoje muskujt e imët të dorë.<br><br>25. Të arrijë shkathtësinë e mbajtjes së trupit apo pjesës së trupit në mënyrë të drejt gjatë aktivitetit.<br><br>26. Të arrijë t'i mbaj dhe t'i perdor drejt mjetet dhe materialet e punes (lapsi, ngjyra etj).<br><br>27. Të zhvillojë ndjenjen e orientimit ne hapsira te kufizuara (ne banke, ne fletore, vizatim etj.) | • **Shkrimi**<br>Ushtronë në shkathtësimin e muskujve të imët të dorës , nëpërmjet: Vizatimit, (vizatojnë objekte e gjësende të cilat përmbajnë elemente të shkronjave, përkatësisht të grafemave të shkronjës) modelimit,(modelojnë me<br><br>- Mjete e materiale të ndryshme figura dhe grafema të shkronjës) konstruktimit(konstruktojnë mbi bazën e modelit apo përfytyrimit grafikun e shkronjës)<br><br>Ushtronë mbajtjen përkatësisht pozicionin e trupit ose një pjese të tij në mënyrë të drejtë gjatë punës ( qoftë vizatim, figura apo vija të ndryshme);<br><br>Ushtronë mbajtjen dhe përdorimin e drejtë të mjeteve të punës (si p.sh. lapsi, ngjyra etj.);<br>Kuptonë dhe përvetësojnë orientimin në hapësirë, në letër, në fletë vizatimi, etj.; | Ka të formuar shprehi dhe kupton rëndësinë e qëndrimit të drejtë të pozitës së trupit e të dorëve gjatë punës me laps, ngjyra etj.;din të mbajnë drejt lapsin, ngjyrën apo ndonjë mjet tjetër pune; Orientohet drejt në hapësirën e kufizuar (në letër, në fletore etj.)Shpreh kënaqësi dhe i përjetonë përmbajtjet e lexuara. Njeh librin si burim të informacionit.<br>dinë të përshkruanë personazhe,ngjarje e situata jetësore;dallonë ndryshimet ndërmjet gjuhës letrare dhe lokalizmave; njeh përmbajtje të krijimeve letrare nga kultura aktuale e vendit; tregonë dhe përpunon tregime të ndryshme nga jeta.<br>Tenton të krijonë libërtha nga jeta e tij.<br>njeh funksionin e të lexuarit; dinë të komunikojnë përmes roleve në lojëra dramatike.<br>është aftë t'i shprehin synimet vetanake dhe t'i përshkruajë ato; Tregonë interes dhe komunikonë për krijimet e tij dhe të tjerëve;<br>Tregon shkathtesi te muskujve te imte te dores; mban trupin apo pjeset e trupit ne menyre te drejt. |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| **OBJEKTIVAT E VEÇANTA** | **AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS** | **REZULTATET E PRITSHME** |
|---|---|---|
| 1. Të zhvillojë më tutje aftësin e të dëgjuarit në kuptimin e pranimit të informative dhe mesazheve;<br><br>2. Të shkathtësohet për të dëgjuarit aktiv dhe për të kuptuar e vlerësuar të tjerët që flasin;<br><br>3. Të zhvillojë të dëgjuarit e teksteve letrare dhe jo letrare dhe identifikimi e tyre;<br><br>4. Të zhvillohet të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës së folur e të shkruar dhe organizimin e saj strukturor; | • **Të dëgjuarit**<br>Të dëgjuarit informativ<br>Dëgjon, merr dhe regjistron informata e mesazhe të ndryshme nga prindi, edukatorja, familja,mjedisi, nga radio, tv, kinemaja, teatri etj.<br>Dëgjon, merr dhe regjistron informata e mesazhe të ndryshme për dhe në situata të caktuar të cilat ndikojnë dhe krijojnë afrimitet me një ose më shumë njerëz.<br>Të dëgjuarit efektiv<br>Dëgjon prezantime gojore të moshatarëve dhe të rriturve për tema të caktuara ( ngjarje, tregime të ndryshme, histori të shkurtra etj) reagon në mënyrë aktive për t'i kuptuar, qartësuar dhe vlerësuar më mirë të tjerët.<br>Dëgjon aktivisht folësit, diskuton dhe ndihmon veten e bashkëbiseduesit në sqarimin e mesazheve të pranuara për të dhënë përgjigje në grup dhe nivele të ndryshme njerëzish, i komenton dhe i parafrazon ato.<br>Të dëgjuarit e teksteve<br>Dëgjon tekste të zakonshme joletrare të karakterit ( si urime, falënderime, porosi, ftesa, letër e shkurtër etj) njohës, didaktik, dokumentar;<br>Dëgjon dhe identifikon format e thjeshta letrare: Fjalët e urta, gjëegjëzat, përrallëzat, përrallat, tregimet e shkurtra, vjersha të shkurtra dhe lojërat didaktike.<br>Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës | Të jete i aftë të dëgjojë dhe kuptojë informatat e mesazhet nga të tjerët;<br><br>Të kuptojë prezantimet gojore dhe t'i vlerësojë ato;<br><br>Të ketë ndjesi dhe durim në të dëgjuarit aktiv në grup; |

## GRUP-MOSHA 5-6

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 5. Të aftësohet në të dëgjuarit dhe përvetësimin e pasurimi i fjalorit me fjalë e shprehje të reja nga fushat e ndryshme të jetës;<br><br>6. Vazhdon të zhvilloj të folurit në funksion të marrësit dhe dhënësit të informacionit, mesazhit të caktuar;<br><br>7. Të folurit aktiv në grup,prezantimet gojore dhe rregullat e komunikimit;<br><br>8. Të aftësohet në të folur të standardizuar, shqiptim dhe drejtshqiptimi i fjalive, fjalëve, tingujve;<br><br>9. Të zhvillojë të folurit në funksion të zgjerimit të leksikut përkatësisht pasurimit të fjalorit me fjalë dhe me shprehje të reja; | Dëgjon dhe kupton se gjuha e folur dhe e shkruar është e organizuar në nivele të tingujve, fjalëve, fjalive, ligjëratës etj.<br>Gjatë prezantimeve të ndryshme, dëgjon dhe përvetëson : të shqiptuarit e tingujve zanor dhe bashkëtingëllor, rrokjeve dhe fjalëve; drejtshqiptimin dhe intonacionin.<br>**Të dëgjuarit dhe përvetësimi i leksikut**<br>Dëgjon dhe pasuron fjalorin me fjalë të reja, me shprehje të veçanta gjuhësore, me fjali dhe fraza nga fusha të ndryshme të jetës.<br>• **Të folurit**<br>**Të folurit në funksion të marrësit dhe dhënësit të informacionit**<br>Përmes akteve të të folurit prezantonë veten, transmetjnë ose përcjellin një propozim, një kundërshtim, një deklarim, një porosi, një dëshirë në mënyrë të tillë që folësi i kësaj moshe të angazhon vetën dhe të tjerët në dëgjim dhe komunikim të mirë.<br>**Të folurit aktiv në grup**<br>Bënë prezantime gojore për një temë të caktuar, diskutojnë në mënyrë aktive për atë që kanë dëgjuar, japin përgjigje në grup;<br>Rrisin dhe shfaqin aftësitë e të folurit në grup duke respektuar rregullat e komunikimit si:kujdesi për bashkëbiseduesin, respekti i dyanshëm, dëgjimi aktiv etj. | Të kuptojë tekste të thjeshta jo letrare e letrare ;<br><br>Të dëgjojë tinguj të ndryshëm, fjalë dhe në to të dallojnë rrokjet;<br><br>Përmes akteve të të folurit të dijë të prezantojë veten e tjerët, të propozojnë, të kundërshtojnë etj.<br><br>Të dijë të bëjnë prezantime gojore për një temë të caktuar;<br><br>Të kuptojë të folurit në grup duke respektuar rregullat e komunikimit; |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 10. Të zhvillojë të folurit që të vehet në funksion të teksteve të përshtatshme letrare dhe jo letrare që lidhen me botën dhe interesimet e tyre;<br><br>11. Të pasurojë dhe të zgjerojë të folurit jo verbal përmes gjuhës së trupit; | **Të folurit në funksion gjuhësor**<br>Gjatë të folurit shqiptonë drejtë: tingujt zanor dhe bashkëtingëllor ( sidomos: gj,xh, r,rr, s, sh, ç, q etj ) dhe lidhjen e tyre në rrokje; ndarjen e fjalës në rrokje; kuptimin e fjalisë etj.<br>Gjatë të folurit dhe komunikimit shqiptojnë drejtë dhe me intonacion fjalët dhe fjalitë.<br>**Të folurit në funksion të zgjerimit të leksikut**<br>Gjatë të folurit aktiv, fëmija i këtij moshe, pasuronë fjalorin e tyre me fjalë dhe shprehje të cilat lidhen me përditshmërinë në fushat e ndryshme të jetës.<br>**Të folurit në funksion të teksteve letrare dhe joletrare**<br>Flet dhe parafrazonë tekste të thjeshta joletrare që lidhen me botën e tyre dhe interesimet e tyre;<br>Flet, parafrazonë e ritregonë, recitonë dhe luanë në role tekste letrare: përrallëza, përralla, gjëegjëza, tregime të shkurtra, vjersha, pjesë dramatike etj.<br>**Të folurit joverbal (jogojor )**<br>Të folurit joverbal përmes shprehive e veçorive të ndjenjave emocionale;<br>Përvetësimi i ndjenjës joverbale përmes mimikës së fytyrës, mimikës së veprimit ( gjestikulacioneve ) dhe shikimit. | Të shqipton drejtë tingujt, fjalët, fjalitë e thjeshta duke pasur kujdes intonacionin;<br><br>Të flet, parafrazonë, ritregonë, recitonë e luanë në role tekste letrare dhe jo letrare;<br><br>Të përvetëson ndjenjat jo verbale për mes mimikës dhe shikimit. |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 12.Të tregojë interes për libërthat, ilustracionet, fotografite, revistate etj.<br>13.Të shkathtësohet për të identifikuar veçuar e prerë fotografi e figura që lidhen me një tematikë të caktuar.<br>14. Aftësohet në të "lexuarit " e teksteve prezantuese dhe mbishkrimeve të vizatuara apo të shtypura;<br>15. Aftësohet në të lexuarit e ilustrimeve, fotografive , figurave, vizatimeve dhe objekteve;<br>16. Të ushtrojë aftësinë dhe shkathtësia për të shkruar, ndjeshmëria për orientim në hapësirë si dhe shprehinë e të mbajturit drejt të trupit;<br>17. Të zhvillojë të menduarit e pavarur për atë që dëgjon dhe flet dhe të formojë qëndrim, mirësjellje,vullnet për bashkëpunim;<br>18. Të zhvillojë përjetim, qëndrim dhe mendim pozitiv për librin;<br>19. Të vazhdojë të zhvillojë aftësinë për krijimtari letrare fëmijërore;<br>20. Të zhvillojë aftësitë e përshkrimit dhe analizës së parë të personazheve, ngjarjeve,dhe situatave jetësore;<br>21. Të zhvillojë më tej aftësinë për të rrëfyer dhe përpunuar tregime e ngjarje të llojllojshme nga jeta dhe krijuar "libërtha";<br>22. Të vetdijësohet për funksionin e të lexuarit e të shkruarit; | • **Të "Lexuarit"**<br>**Njohja me tekste të shkruara**<br>Shfletonë librin, revistën, gazetën dhe dallonë pjesën me fotografi dhe pjesën me shkronja;<br>I flasin përkatësisht i "lexojnë"(leximi i parashkollorit) ilustrimet, fotografitë që paraqesin objekte, figura dhe gjëra tjera të njohura dhe të panjohura për moshën e tyre;<br>Nga revistat, gazetat dhe materialet e ndryshme presin fotografitë e figurat që lidhen me një tematikë të caktuar për të cilën bëhet fjalë;<br>"Lexonë" urdhra , ndalesa dhe vërejtje të vizatuara apo të shtypura ( p.sh. shenjat e komunikacionit );<br><br>**" Lexonë' tekste prezantuese**<br>" Lexonë" dhe kuptojnë shpalljet e shkurtra të vizatuara nga mjedisi i tyre;<br>" Lexonë" mbishkrimet e vizatuara apo të shtypura;<br>" Lexonë" shenjat e ndryshme të vizatuara apo të shtypura që lidhen me një temë të caktuar. | Të njeh dhe dallojë pjesën me fotografi dhe pjesën e shkruar;<br><br>Të dinë rëndësinë dhe funksionin e të lexuarit;<br><br>"Lexon" ilustrimet, fotografitë, figurat dhe objektet e ndryshme në të cilat ka mbishkrim;<br><br>"Lexon" përmes shenjave dhe mbishkrimeve tekste të ndaluara, vërejtje, urdhëresa etj. |

GRUP-MOSHA 5-6

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 23. Të zhvillojë më tutje komunikimin ideve përmes lojërave me rrole,teatrit të kukullave dhe dramatizimit;<br>24. Të pavarësohet dhe të zhvillohet vetëbesimi për t"i shpreh synimet personale dhe aftësia e përshkrimit të tyre ;<br>25. Të shkathtësohe për bashkëbisedim e vetëvlerësim , dhe, vlerësimin e veprimeve të tyre e të tjerëve.<br><br>26. Të arijë shkathtësi më të lartë të muskujve të imtë të dorës dhe gishtërinjëve.<br>27. Të arrijë shkathtësi më të lartë të mbajtjes së trupit dhe pjesëve të trupit në mënyrë të drejt.<br>28. Të shkathtësohet për të mbajtur dhe përdorur drejt mjete dhe materialet e ndryshme të punës.<br>29. Të arrijë shkathtësinë e orientimit në hapsirën e kufizuar. | • **" Shkrimi "**<br>Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si: vizatimit, modelimit, konstruktimit...etj.,vazhdonë të ushtrohen në zhvillimin e shkathtësisë së të shkruarit.(në këto aktivitete gërshetohen elementet e grafikut të shkronjave).<br>Ushtronë mbajtjen përkatësisht pozicionin e trupit ose një pjese të tij në mënyrë të drejtë gjatë punës ( qoftë vizatim, figura apo modelime të ndryshme);Ushtrojnë mbajtjen dhe përdorimin e drejtë të mjeteve të punës (si p.sh. lapsi, ngjyra etj.);<br>Kuptonë dhe përvetësojnë orientimin në hapësirë, në letër, në fletë vizatimi, në fletore etj.; | Fitonë shkathtësi në të vizatuar modeluar dhe krijojnë shprehi në mbajtjen e drejtë të pozitës së trupit dhe të dorës gjatë punës me laps, ngjyra dhe mjete tjera;<br>Të tregojë shkathtësi gjatë manipulimit me lapsin, ngjyrën apo ndonjë mjet tjetër pune;<br>Kuptonë dhe dinë të orientohen në mënyrë racionale në hapësirën në letër, në fletore dhe në mjete tjera të punës.<br>Kanë qëndrim dhe mendim pozitiv për librin;<br>Tregon interes për krijime letrare dhe krijime vetanake;<br>Analizon personazhet, ngjarjet dhe situatat e përjetuara;<br>Rrëfen dhe përpunonë tregime nga konteksti jetësor dhe manifestojnë aftësi për të krijuar "libërtha";<br>Kupton funksionimin e të lexuarit dhe të shkruarit;<br>Komunikon idetë përmes lojërave me role-teatrit të kukullave dhe dramatizimit;<br>Shpreh synimet personale, përshkruan dhe vetvlerëson veprimet;<br>Komunikonë dhe vlerësojnë krijimet e tij dhe të tjerëve . |

## IV. II. 11. Integrimi ndërfushorë

Aktivitetet edukative në fushën e gjuhës amtare ofrojnë mundësi të shumëllojshme të ndërthuren me përmbajtjet e fushave të tjera edukative në kurikulë.

Përmbajtjet letrare dhe jo letrare ,lojërat e llojllojshme didaktike(lojëra imituese, me role, të imagjinuara, teatri i kukullave, dramatizimi ,..etj) janë resurse të favorshme jo vetëm të zhvillimit të folurit dhe të pasurimit të fondit të fjalorit gjuhësor por edhe të njohjes dhe të kuptuarit e dukurive,mjeteve dhe raportet në mjedisin e tyre jetësor.

Njohja e vetës dhe botës realizohet përmes përmbajtjeve të ndryshme të përrallëzave, tregimeve, rrëfimeve etj.

Fëmijët njohin dhe vetëdijësohen për rëndësinë e ruajtjes së shëndetit, mënyrat e ushqyerit të shëndoshë, veshmbathjen në stinë të ndryshme, mbajtjen e higjienës personale,etj .

Leximi i tregimeve ,teksteve të ilustruara të cilat ndërthuren me përditshmërinë e jetës së fëmijës janë burime relevante te cilat ndihmojnë zhvillimin e aftësisë së të dëgjuarit aktiv të fëmijës si dhe motivojnë komunikimin verbal dhe atë jo verbal të tij. Ndërthurja e përmbajtjeve nga fusha e njohjes së vetës dhe botës në aktivitete gjuhësorë krijon shanse që fëmijët njëherit të nihen me botën e gjallë dhe jo të gjallë.( vetën e tij ,shoqërinë,kultura, botën bimore e shtazore,objekte e gjësende të ndryshme, institucione…etj). Duke komunikuar në këto përmbajtje tematike fëmijët zhvillojnë shkathtësi të prezantojnë veten,të bëjnë prezantime gojore,të parafrazojnë,ritregojnë,të përvetësojnë ndjenjat jo verbale,të kuptojnë rëndësinë e të folurit në grup,…etj.

Përmes lojërave të edukimit fizik dramatike,imituese, ritmike…etj. fëmijët njohin dhe komunikojnë me gjuhën e trupit,përkatësisht aftësohen për të përdorë të folurit verbal dhe jo verbal .Lojërat me imitime të zërave të ndryshme të shtazëve ku vehen në lëvizje gjymtyrët e trupit,vallëzimet individuale dhe në grupe zhvillojnë elasticitetin dhe aftësinë e koordinimit të lëvizjeve, ndjesinë për ritëm e harmoni.

Duke përshkruar, treguar, rrëfyer, për figurat e objekteve apo ngjarjeve e situatë konkrete që janë në funksion të zhvillimit të gjuhës, fëmijët kanë mundësi të nihen edhe me shumë nocione matematike (njohin dhe i dallojnë ngjyrat format, pozitën, kohën, përmasat, relacionet, bëjnë krahasime, analizë, sintezë, vejnë hipoteza, vlerësojnë…etj.

Edukimi muzikor i integruar në kultivimin e gjuhës gjënë shprehje gjatë vallëzimit, lojërave ritmike, këndimit,…etj. Aktivitetet e gjuhës të integruara më veprime muzikore manifestojë jo vetëm emocione pozitive por, njëherit në këto situata edukative zhvillohet dhe ushtrohet shqiptimi i drejtë i tingujve, fjalëve, fjalive. Zhvillohet aftësia e dëgjimit,harmonia e shprehjes gjuhësore-krijimi i qëndrimit pozitiv ndaj gjuhës.

Dashuria dhe interesi për librin,për leximin dhe shkrimin parashkollor zgjerohet dhe thellohet përmes aktiviteteve të artit figurative. Ilustracionet të shoqëruara me tekst,vizatimi i figurave,objekteve e gjësendeve të llojllojshme të përafërta me mjedisin jetësor të fëmijës ndërthuren dhe lehtësojnë perceptimin e grafemave të shkronjave, ofrojnë mundësi të zhvillimit të “lexuarit” dhe “shkrimit” të parashkollorit etj .Arti aplikativ-albume të bëra me aplikacione me materiale të llojllojshme nga vet fëmijët (etiketa, fotografi, tekste në revista e gazeta) nxitë dhe motivon fëmijët në të folur, në shprehjen e përjetimeve, interesit për lexim dhe shkrim,…etj.

.

**FUSHA E AKTIVITETIT:**

**IV. III. EDUKATA ARTISTIKE**
**IV. III/1 EDUKATA MUZIKORE**
**IV. III /2 EDUKATA FIGURATIVE**

## IV.3. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME GRUP MOSHA 3 – 6

1. Të zhvillojë aftësinë e perceptimit shqisor të drejtë të mjedisit jetësor ndërveprues.

2. Të aftësohet të perceptojë botën dhe mjedisin jetësor me sa më shumë shqisa dhe të pasurojë përceptimin dhe përvojën shqisore.

3. Të zhvillojë aftësinë e përftyrimit dhe shprehjes së përjetimeve.

4. Të zhvillojë ndjeshmërinë dhe imagjinatën krijuese.

5. Të zhvillojë potencialet dhe prirjet individuale, kërshërinë kërkuese, pavarësinë për zgjedhje të lire të të shprehurit dhe origjinalitetet në të shprehur.

6. Të aftësohet për komunikim emocional pozitiv me artin.

7. Të pasurojë gjuhën shprehëse.

8. Të njohë dhe të përvetësojë fjalorin themelor të arteve të ndryshme.

9. Të njohë mjetet themelore të arteve dhe të krijoj shkathtësitë dhe shprehitë elemntare të përdorimit të tyre.

10. Të niset zhvillimi i aftësive estetike-shijes estetike.

11. Të aftësohet t’i shprehë perceptimet, imagjinatën, mendimet dhe ndjenjat përmes aktiviteteve estetike-artistike dhe të komunikojë me të tjerët përmes tyre.

12. Të aftësohet për pjesëmarrje të vazhdueshme aktive individuale dhe grupore në format e caktuara të shprehjes dhe komunikimit shprehës.

## IV. III/1. EDUKIMI MUZIKOR

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të aftësohet t`i dëgjojnë dhe përjetojnë tingujt dhe zërat e natyrës<br><br>2. Të shpreh kurreshtje për aktivitetete muzikore, të zhvillojë emocione të këndëshme gjatë aktiviteteve muzikore dhe të synojnë t`i shprehin ato.<br><br>3. Të edukojë dëgjimin e muzikës vokale dhe instrumentale i zhanreve të ndryshme muzikore<br><br>4. Të zhvillojë aftësitë muzikore ndjenjën për ritëm, melodi, harmoni etj.<br><br>5. Të aftësohet t`i imitojnë zërat dhe tingujt e dëgjuar të natyrës dhe muzikës<br><br>6. Të aftësohet t`i shpreh përjetimet muzikore përmes lëvizjeve. | • **Dëgjimi**<br>Fëmija shfrytëzon situatat e përditshmërisë jetësore në të cilat perceptojnë zëre, tingujt nga mjedisi jetësor;<br>Përmes aktiviteteve të ndryshme dëgjojnë dhe identifikojnë zëret tingujt…,etj.<br>Dëgjon zëret e shpezëve dhe të kafshëve ;<br>Përmes aktiviteteve të ndryshme fëmijët dëgjojnë në mënyrë aktive kompozimet e zhanreve të ndryshme muzikore;.<br>Organizohet aktivitete njohëse përmes të cilave fëmijët dëgjojnë dhe përjetojnë kompozime muzikore për fëmijë;<br>Përmes aktiviteteve muzikore fëmija dëgjon në mënyrë aktive dhe shpreh përjetimet e tij;<br>Në aktivitetet muzikore të fëmijëve dhe për fëmijët dëgjojnë në mënyrë aktive;<br>Zhvillon aktivitete muzikore përmes të cilave fëmija kënaqet duke dëgjuar...<br>• **I n t e r p r e t i m i**<br>Imiton zëra dhe tinguj nga natyra dhe mjedisi jetësor<br>Imiton ligjërimet dhe këngët e ndryshme muzikore<br>Këndojnë këngë për fëmijë, këngë popullore dhe artistike brenda mundësive të fëmijës<br>Muzikën për fëmijë, ligjërimet etj. i shoqërojnë me duartrokitje, me trokitje të këmbëve etj.<br>Luajnë në mjete dhe vegla muzikore. | Dëgjon dhe përjetojnë tingujt dhe zërat e natyrës<br><br>Tregon kurreshtje për aktivitetetet muzikore, kënaqen gjatë aktiviteteve muzikore dhe të synojnë t`i shprehin emiocionet e këndshme.<br><br>Dëgjon muzikë vokale dhe instrumentale të zhanreve të ndryshme muzikore<br><br>Shpreh ndjesinë për ritëm, melodi, harmoni etj.<br><br>Imiton zërat dhe tingujt e dëgjuar të natyrës dhe muzikës<br><br>Shpreh përjetimet muzikore përmes lëvizjeve |

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
| --- | --- | --- |
| 7. Të nxitet për nismën e shprehjes kreative të ritmit<br><br>8. Të njihet me vegla muzikore dhe të provojë të luajnë në to | Këndojë përrallëza muzikore<br>Shoqërojnë interpretimet e fëmijëve të tjerë dhe të rriturve<br><br>• **K r i j i m i**<br>Duke luajtur krijojnë tinguj dhe zëra nga natyra dhe mjedisi jetësor i tyre.<br><br>Luajnë lojra të thjeshta ritmike, bëjnë lëvizje harmonike<br>Në lojrat ritmike përdorin rekuizita të theshta muzikore.<br><br>Me vegla dhe mjete muzikore shprehin me zë përjetimet dhe përfytyrimet tingullore nga mjedisi jetësor.<br><br>Krijojnë ligjerime dhe këngë duke i shoqëruara me mjete dhe vegla muzikore<br>Me vegla muzikore demonstron ndonjë ngjarje apo ndodhi të shkurtër<br>Përmes ligjerimit ritmik dhe këndimit shprehin imagjinatën dhe përjetimet individuale<br>Me mjetetet e arteve të tjera shpreh përjetimet muzikore<br>Krijojnë shfaqje të thjeshta me elemente muzikore | Bënë orvatje të shprehjes kreative të ritmit<br><br>Njeh dhe i emërtonë disa vegla muzikore dhe të provojnë të luajnë në to |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të aftësohet për të dëgjuar muzikë vokale dhe instrumentale të zhanreve të ndryshme<br><br>2. Të njoh veprat muzikore për fëmijë etj.<br><br>3. T`i ketë të zhvilluara aftësitë muzikore – ndjenjën për ritëm, melodi, harmoni etj.<br><br>4. Të aftësohet për imitim dhe reprodukim kreativ të ritmit, melodisë, harmonisë etj.<br><br>5. Të përceptojë dhe dallojë muzikën vokale dhe atë instrumentale.<br><br>6. Të dallojë cilësitë e tingujve në natyrë dhe muzikë<br><br>7. Të aftësohet të shprehin përjetimet muzikore përmes lëvizjeve dhe vallëzimit.<br><br>8. Të zgjërojë njohuritë dhe të shkathtësohen për luajtje fillestare në vegla muzikore.<br><br>9. Të aftësohet të këndojnë përmbajtje muzikore<br><br>10. Të zhvillojë ndjesinë për pjesmarrje në aktivitetetet e përbashkëta muzikore. | • **Dëgjimi**<br>Situatat e përditshmërisë shfrytëzohen për perceptimin e zërave dhe tingujve nga mjedisi jetësor i tyre ;<br>Përmes aktiviteteve të ndryshme dëgjojnë në mënyrë aktive dhe bëjnë seleksionimin dhe dallimin e zërave , tingujve.(zëret e njerëzve, shpendëve kafshëve dukurive natyrore,…etj.);<br>Dëgjojnë tinguj muzikorë përmes këngës dhe instrumenteve të llojllojshme;<br>Dëgjojnë në mënyrë aktive kompozimet e zhanreve të ndryshme muzikore;<br>Organizojnë aktivitete njohëse përmes të cilave fëmijët dëgjojnë dhe përjetojnë kompozime muzikore;<br>Në aktivitete të fëmijëve, dhe për fëmijët, dëgjojnë në mënyrë aktive;<br>Përmes aktiviteteve të ndryshme muzikore, fëmijët përjetojnë dhe i shprehin përjetimet e tyre muzikore;<br>Zhvillojnë aktivitete përmes të cilave fëmijët kënaqen duke dëgjuar muzikë.<br><br>• **I n t e r p r e t i m i**<br>Vazhdon të imitojë zërat dhe tingujt e ndryshëm të natyrës dhe mjedisit jetësor<br>Interpretojnë ligjerime dhe këngë të ndryshme në vegla dhe mjete muzikore.<br>Këndojnë këngë për fëmijë, këngë popullore e artistike në harmoni me mundësitë e tyre | Dëgjon muzikë vokale dhe instrumentale të zhanreve të ndryshme<br><br>Këndon përmbajtje muzikore<br><br>Ka ndjesi për ritëm, melodi, harmoni etj.<br><br>Njeh veprat muzikore për fëmijë etj.<br><br>Imiton dhe reprodukon në mënyrë kreative ritmin, melodinë, harmoninë etj.<br><br>Dallon muzikën vokale dhe atë instrumentale<br><br>Dallon cilësitë e tingujve në natyrë dhe muzikë |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 11. Të zhvillohet aftësia në drejtim të përqendrimit të vëmendjes për ndjesin e trupit ndaj ndikimeve të tingullit dhe ritmit për rreth- "dëgjim i vetvetës"<br><br>12. Të zhvillohejë fillet e gjykimit të vlerave estetike në muzikë.<br><br>13. Të zgjërojë dhe shfrytëzojë fjalorin muzikor | Ligjërimet ritmike i shoqërojnë me lëvizje<br>Këndon këngë dhe luan në mjete e vegla muzikore<br>Vazhdon të këndojë përralla muzikore<br>Interpreton tingujt dhe zërat duke krijuar situata muzikore më komplekse<br>Shoqëron interpretimet vokale dhe instrumentale të fëmijëve të tjerë apo të rriturve.<br><br>• **Krijimi**<br>Luan duke interpretuar zëra dhe tinguj nga mjedisi jetësor<br>Luan lojra të shoqëruara me muzikë<br>Luan lojra ritmike duke përdoruru mjete dhe vegla të thjeshta muzikore<br>Përmes veglave dhe mjeteve muzikore shprehin me këng përjetimet tingullore të mjedisit jetësor<br>Me vegla muzikore krijojnë ndonjë ngjarje<br>Përmes ligjerimit dhe këndimit vazhdonë të shprehin imagjinatën dhe përjetimin individual<br>Përjetimet muzikore i shpreh me mjetetet e arteve të tjera<br>Sajon modele ritmike-melodike<br>Krijon shfaqje muzikore<br>Këngët dhe shprehjet ritmike i shoqëron me vegla muzikore dhe me vallëzim<br>Përcjell krijimet e fëmijëve të tjerë dhe të rriturve | Shpreh përjetimet muzikore përmes lëvizjeve dhe vallëzimit<br><br>Posedon njohuritë dhe shkathtësi fillestare për luajtje në vegla muzikore<br><br>Ka ndjesinë për pjesëmarrje në aktivitetetet e përbashkëta muzikore<br><br>Përqendronë vëmendjen në ndjesin e trupit ndaj ndikimeve të tingullit dhe ritmit për rreth- "dëgjonë vetën"<br><br>Jep gjykimit fillestare për vlerave estetike në muzikë<br><br>Ka dhe shfrytëzonë fjalorin muzikor |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të aftësohet për dëgjim aktivi të muzikën duke i përjetuar dhe njohur cilësitë e saj<br><br>2. Vazhdon ta zhvillojë dhe shfrytëzojë fjalorin muzikor.<br><br>3. Të njeh vepra muzikore, krijuese e interpretuese.<br><br>4. Të përjetonë muzikën si burim gëzimi, argëtimi e çlodhjeje.<br><br>5. Të aftësohet të vërejnë e dallojnë karakterin shprehës, mjetetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore që i dëgjon.<br><br>6. Të aftësohet të dallojnë cilësitë e tingullit muzikorë, lëvizjen ngjitëse dhe zbritëse të melodive, gradacionet në tempo dhe ngjyrimet dinamike në këndim.<br><br>7. Të shpreh përjetimet muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative e gjuhësore<br><br>8. Të zhvillonë shkathtësi interpretuese (Teknikat e këndimit dhe të luajtjes në vegla muzikore) | • **Dëgjimi**<br>Shfrytëzohen situatat e përditshmërisë jetësore nga të cilat fëmijët perceptojnë zëret, tinguj në natyrë dhe mjedise të tjera edukative ;<br>Vazhdon të dëgjojë përmes aktiviteteve të ndryshme muzikore dhe bëjnë seleksionimin dhe dallimin e zërave dhe tingujve të ndryshëm;<br>Dëgjon në mënyrë aktive tinguj muzikorë përmes këngës,dhe instrumenteve të ndryshëm;<br>Përmes aktiviteteve të ndryshëm dëgjojnë në mënyrë aktive kompozimet të zhanreve të ndryshme muzikore;<br>Dëgjon dhe identifikojnë tingujt e instrumenteve të ndryshëm muzikor;<br>Zhvillon aktivitete njohëse përmes së cilave fëmijët dëgjojnë dhe përjetojnë kompozime muzikore për fëmijë;<br>Përmes aktiviteteve muzikore realizojnë dëgjim aktiv dhe shprehin përjetimet e tyre;<br>Dëgjon muzikë të krijuara nga vet ata dhe nga të tjerët;<br>Zhvillon aktivitete përmes së cilave kënaqen duke dëgjuar muzikë.<br>• **I n t e r p r e t i m i**<br>Imiton në mënyrë kreative zërat, tingujt dhe muzikën<br>Vazhdon të interpretojë ligjerime dhe këngë të ndryshme<br>Interpreton në mënyrë kreative këngë për fëmijë, këngë popullore e artistike të përshtatshme për fëmijë | Dëgjon aktivisht muzikën, përjetojnë dhe njohin cilësit e sajë<br><br>Këndon dhe luajnë përmbajtje muzikore<br><br>Demonstron shkathtësi interpretuese – teknikat e këndimit dhe të luajtjes në vegla muzikore<br><br>Njeh vepra muzikore, krijues dhe interpretues të muzikës<br><br>Ka më të zhvilluar dhe eshfrytëzojnë fjalorin muzikor<br><br>Shpreh përjetimet muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative dhe gjuhësore |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 9. Të këndonë këngë për fëmijë, këngë popullore e artistike me dhe pa shoqërim instrumental.<br><br>10. Të zhvillonë kulturën vokale duke respektuar kërkesat e këndimit të bukur dhe të drejtë (pozicioni, frymëmarrja,diksioni, kantilena etj.)<br><br>11. Të aftësohet të këndojë dhe të luaj përmbajtje muzikore.<br><br>12.Të inkurajohet për kreativitetet muzikor | Këndon muzikë ritmike dhe i shoqëron me lëvizje dhe vegla muzikore<br>Këndon këngë të zhanreve të ndryshme muzikore<br>Interpreton tinguj, ritëm dhe muzikë duke krijuar situata muzikore<br>Shoqëron interpretimet vokale dhe instrumentale të fëmijëve të tjerë dhe të rriturve<br>Interpreton këngë të shoqëruara me instrumente.<br>• **Krijimi**<br>Luan duke interpretuar zëra dhe tinguj nga natyra dhe mjedisi jetësor; Luajnë lojra të shoqëruara me muzikë; Luajnë lojra ritmike duke përdorur mjete dhe vegla muzikore<br>Përmes veglave dhe mjeteve muzikore shprehin me këngë përjetimet dhe përfytyrimet tingullore të mjedisit jetësor<br>Me vegla muzikore krijon ngjarje të thjeshta apo edhe më të përbëra<br>Ligjëron dhe këndon për të shprehur imagjinatën dhe përjetimet individuale<br>Përjetimet muzikore i shpreh me mjetetet e arteve të tjera<br>Krijon modele ritmike – melodike dhe melioditë e para<br>Krijon shfaqje muzikore.<br>Këngët dhe shprehjet ritmike i shoqërojnë me vegla muzikore dhe me vallëzim<br>Përcjellin veprimtaritë e fëmijëve të tjerë dhe të rriturve<br>Përcjellin krijimet muzikore të kulturave të tjera | Këndon këngë për fëmijë si dhe ato popullore e artistike të përshtatshme për fëmijët me dhe pa shoqërim instrumental<br><br>Përjeton muzikën si burim gëzimi, argëtimi dhe çlodhjeje<br><br>Vëren dhe dallojnë karakterin shprehës, mjetetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore që i dëgjojnë<br><br>Ka kulturën fillestare vokale- respektonë kërkesat e këndimit të bukur dhe të drejtë (pozicioni, frymëmarrja, diksioni, etj.)<br><br>Dallon cilësitë e tingullit muzikorë, lëvizjen ngjitëse dhe zbritëse të melodive, gradacionet në tempo dhe ngjyrimet dinamike në këndim<br><br>Bënë tentime të kreativitet muzikor |

## IV. III / I. 11. Integrimi ndërfushor

Edukimi muzikor është fushë edukative e cila integrohet natyrshëm me fushat e tjera të kurikulit. Integrimi ndërfushor bëhet gjatë gjithë procesit të edukimit parashkollor.

E veçanta e edukimit muzikor është se shtrihet në të gjitha aktivitetetet e fëmijës parashkollor, i nxitë dhe i frymëzon fëmijët për aktivitetete të ndryshme.

Aftësitë muzikore zhvillohen jo vetëm me aktivitetet muzikor por edhe përmes aktivitetetve në fushat e tjera edukative, e duke i ndërlidhur me kontekstin jetësor të fëmijës.

Aktivitetet e ndryshme të fëmijës në natyrë dhe mjedisin jetësor (social) të tij , i mundësojnë të njoh tinguj e zëra të ndryshëm të botës së gjallë dhe jo të gjallë.

Kompozimet me karakter të gëzueshëm, të shpejtë, të qetë, marrshimet etj. të integruara me personazhet apo dukurit e ndryshme , fëmijët i dëgjojnë, i përfytyrojnë dhe i imitojnë lëvizjet e tyre, me çka plotësojnë përfytyrimet për botën dhe zhvillojnë fizikun dhe shëndetin e tyre

Edukimi fizik e shëndetësor i ofron mundësi fëmijës të zhvillojë ndjesinë për ritmin, harmoninë etj. si dhe të arrijë gjendjen fizike të nevojshme për aktivitetetin muzikor.

Këngët me tema për botën bimore dhe shtazore mundësojnë, nga njëra anë formësimin dhe zgjërimin e nocioneve të fëmijës për botën e nga ana tjetër zhvillohen aftësitë muzikore të tij.

Shqiptimi i tingujve, fjalës dhe fjalisë ka mundësai të realizohet përmes këngës në grup, asaj individuale etj. apo përmes rrëfimit të përrallave, tregimeve apo ngjarjeve nga jeta e përditshme e fëmijës

Vargjet me rimë janë të afërta me fushën e muzikës. Aktivitetetet ritmike si lëvizja me ritëm, ecja sipas ritmit, harmonia e ligjërimit dhe lëvizjes etj. ndihmojnë për t`u zhvilluar aftësia e dallimit të ritmit, melodisë dhe harmonisë së shqiptimit të drejtë të tingujve dhe rimes.

Muzika instrumentale mund të integrohet përmes dramatizimit të teksteve letrare dhe jo letrare.

Loja me kukulla e shoqëruar me muzikë adekuate mundëson përjetimin më të thellë të muzikës dhe lojës.

Lojrat me grupe fëmijësh, gjatë të cilave fëmijët formojnë rrethin, lëvizin lartë – poshtë, pozicionohen para-pas, majtas-djathtas etj, të shoqëruar me muzikë, krijojnë shanse të favorshme që të edukohet jo vetëm muzikaliteti i fëmijës por , në atmosferë të këndshme, fëmija ti njohë dhe kuptojë disa nocione matematike.

Aktivitetetet në fushën e muzikës gërshetohen edhe me artin figurative.Fëmijët me kënaqësi vizatojnë dhe modelojnë lulet, shpezët, shtazët etj. e të cilave u dedikohet kënga.

Integrimi ndërfushor, pra i edukimit muzikor dhe fushave të tjera edukative mundëson zhvillimin dhe edukimin më të natyrshëm e tërësorë të parashkollorit.

**Fusha e aktivitetit:**

**IV.III / II. Edukimi figurativ**

## GRUP-MOSHA 3-4

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të vëzhgojë bukuritë në natyrë, në mjedisin jetësorë;<br><br>2. Të vëzhgojë dhe bisedoj për gjësendetet e ndryshme dhe materiale të ndryshme të artit figurativ;<br><br>3. Të vëzhgojë dhe bisedoj për krijimet e artit figurative,për ngjarjet e përditshmërisë dhe ato të vaçant;<br><br>4. Të vëzhgojë dhe të njeh mjetet e artit figurative;<br><br>5. Të vëzhgojë dhe të njehë veçoritë personale dhe të tjerëve (mosha,gjinia,disponimi, fizikun…etj.);<br><br>6. Të vëzhgojë dhe të njehë shenjat,simbolet në mjedisin jetëso;.<br><br>7. Te njehë krijuesit dhe interpretuesit e artit në ambiente autentike dhe ne mjedisin e kopshtit;<br><br>8. Të vëzhgojë dhe të njeh produktet e artit në kopsht,muze,galeri. bibliotekë..etj; | Shetitë në natyrë, e vëzhgon, përcepton dhe përjeton atë<br>Duke shetitur në natyrë dhe ambientete jetësore të tjera shfrytëzon shqisat e ndryshme për të njohur dhe përjetuar cilësitë e ndryshme si ngjyrën, formën, pozitën, materialin etj.<br>Bisedon për atë që ka vëzhguar , përceptuar e përjetuar në natyrë dhe mjediset e tjera jetësore<br>Luan me vija dhe kënaqet me aktivitetetet e bëra<br>Luan në hapsirë të përmasave të caktuara dhe të pacaktuara me qëllim të përceptimit të masave-dimenzioneve në hapsirë<br>Luan me materiale dhe mjete të ndryshme që mund të shfrytëzohen në artin figurative ( letër, palstelinë, rërë, ujë, material reciklues etj.)<br>Luan me materiale të llojllojshme si rërë, plastelinë, brum, letër, bore etj.duke tërhequr vija të ndryshme – të drejta, të lakuarara, të hapura, të mbyllura, zik-zake, spirale e tj.<br>Bënë aktivitete të ndryshme të artit figurative – me laps, ngjyrëra, brushë etj.<br>Luan me ngjyrëra të ndryshme duke tërhequr vija e formuar figura sipas dëshirës.<br>Bënë aktivitetet figurative përmes të cilave shprehë dukuritë e ndryshme në natyrë (pikat e shiut, fjollat e bores, erën etj.)<br>Bënë aktivitetet të ndryshme për të përceptuar sipërfaqen si hapsirë mbi të cilën bënë aktivitetet figurative të ndryshme | Vëzhgon natyrën dhe mjediset tjera jetësore<br><br>Vëzhgon dhe bisedon për mjetetet dhe materialet që aplikohen në artin figurative<br><br>Vëzhgonë dhe bisedonë për krijimet e artit figurative, për ngajrjet e përditshme dhe të veçanta në këtë fushë<br><br>Vëzhgon dhe njeh veçoritë personale dhe të të tjerëve (moshën, gjininë, fizikun, disponimin etj.)<br><br>Vëzhgon dhe njeh shenjat dhe simbolet në mjedisin jetësor<br><br>Njeh krijuesit dhe interperetues të artit<br><br>Vëzhgon, njeh dhe bisedon për produktet e artit në kopsht, muze, galeri, etj. |

## GRUP-MOSHA 3-4

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 9. Të vëzhgojë e të njeh produktet e artit popullor dhe artistik;<br><br>10. Të njeh me fjalorin elementar të artit figurativ.<br><br>11. Të aftësohet për t'i shpreh përjetimet nga vëzhgimi i natyrës;12. Të kënaqet me aktivitete të artit figurative;<br><br>13. Të krijojë produkte të artit me mjete e materiale të llojllojshme;<br><br>14. Të sajojë shenjat dhe simbolet në jetën e përditshme. | Luan me trupa dhe figura të ndryshme gjeometrike dhe jo gjeometrike-konkave dhe konvekse<br>Luan duke modeluar me plastelinë, rërë, brum, bore etj<br>Gjatë aktivitetetetеve të llojllojshme figurative fillon të krijoj fjalorin e artit figurative<br>Bënë aktivitetete për të zhvilluar ndjesinë për dallimin e ngjyrërave dhe kombinimin e tyre<br>Bënë aktivitetetet të ndryshme në sipërfaqe të rrafsht dhe releve-përcepton dallimin midis tyre<br>Bisedon për krijimet figurative të përbashkëta e individuale<br>Konstrukton kukulla nga tradita e vet dhe e të tjerëve<br>Viziton krijuesit në ambiente autentike të artit figurative dhe bisedojnë me ta<br>Ekspozon krijimet e tyre figurative në institucion parashkollor dhe bisedojnë për të. | Vëzhgon dhe njeh produktetet artistike dhe popullore<br><br>Njeh fjalorin elementar të artit figurative<br><br>Shpreh përjetimet nga vëzhgimi i natyrës<br><br>Shprehë kënaqësi gjatë aktiviteteteve të artit figurative<br><br>Krijon produkte të artit figurative me mjete e materiale të ndryshme<br><br>Sajon shenja dhe simbole në jetën e përditshme |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të vëzhgojë natyrën dhe të komentojë botën e gjallë dhe jot ë gjallë;<br><br>2. Të vëzhgojë dhe të bisedojë për krijimet e artit figurative,për ngjarjet e rastit dhe të veçanta artistike;<br><br>3. Te vazhdoje të vëzhgojë dhe të njeh veçoritë personale dhe të të tjerëve;<br><br>4. Te vazhdoje të vëzhgojë dhe të njeh mjetet dhe materialet e artit figurative;<br><br>5. Të njeh dhe t'i kuptojë shenjat,simbolet e ndryshme në mjedisin e afërt jetësorë;<br><br>6. Të vëzhgojë punën e krijuesve dhe të interpretuesve të artit figurative në mjedise të ndryshme të zhvillojë më tutje vëzhgimin dhe t'i njoh produktet e artit popullor dhe artistik –kombëtarë dhe të popujve të tjerë;<br><br>7. Të shprehë figurativisht përjetimet nga vëzhgimi dhe hulumtimi i natyrës së gjallë dhe jot ë gjallë;<br><br>8. Të pasurojë fondin e fjalorit nga arti figurative; | Bënë aktivitetete të mundshme në natyrë që të ndjejë hapsirën si pjesë të pandarë të jetës<br><br>Gjatë aktivitetetеve të ndryshme në natyrë dhe mjesdiset e tjera jetësore- vëzhgon dhe komenton botën e gjallë dhe jo të gjallë<br><br>Bënë aktivitete ku njeh veçoritë personale dhe të të tjerëve<br><br>Bënë aktivitete të llojllojshme e të vazhdueshme figurative –Vizaton, modelon etj botën e gjallë dhe jo të gjallë (njerëzit, bimët, kafshët, gjësendet, shenja dhe simbole nga mjedisi i afërt jetësor, fenomenet në natyrë)<br><br>Bënë aktivitetetet të ndryshme me mjete dhe materiale të artit figurative, i njeh ato, përdorimin dhe emërtimin e tyre<br><br>Bënë aktivitetet figurative sipas modeleve<br><br>Vizaton, modelon etj. përjetimet nga vëzhgimi i mjedisit jetësor<br><br>Viziton puntoritë, atelete, ekspozita etj. të krijuesve të artit figurative, vëzhgon krijimet dhe bisedon për punën e tyre<br><br>Bisedon me krijuesit e artit figurative që vizitojnë institucionet parashkollore | Vëzhgon natyrën dhe komenton botën e gjallë dhe jo të gjallë<br><br>Vëzhgon dhe bisedon për krijimet e artit figurative, për ngjarjet e rastit dhe të veçanta në këtë fushë<br><br>Njeh veçoritë personale dhe të të tjerëve<br><br>Njeh mjetete dhe materialet e artit figurativ dhe ka fond të fjalorit nga kjo fushë<br><br>Njeh, kupton dhe krijon shenja e simbole të ndryshme në mjedisin e afërt<br><br>Vëzhgon dhe njeh produketet figurative artistike e popullore-kombëtare e të popujve të tjerë<br><br>Shpreh figurativisht përjetimet nga vëzhgimi dhe hulumtimi I natyrës së gjallë dhe jo të gjallë<br><br>Argëtohet dhe shpreh interes për aktivitetetet e artit figurative<br><br>Njeh punën e krijuesve e interpretuesve të artit figurative në mjedise të ndryshme |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 9. Të argëtohet dhe të zhvillojë interesat për art figurativ;<br>të aftësohet të bënë krahasime në produktet e artit figurativ;(format në fotografi, ngjyrat, pozitat, madhësitë, dinamikën…etj.) | Zhvillon aktivitetet në të cilat karahasojnë produktete e artit figurative sipas përmbajtejs, formës, ngjyrërave, pozitës së elementeve, madhësisë, dinamikës etj.<br><br>Ekspozon krijimet e tyre figurative në institucion dhe bisedojnë për to<br><br>Viziton krijimet figurative të ekspozuara në institucionet parashkollore e tjera dhe bisedojnë për to. | Krahason produktete e artit figurative për nga përmbajtja, dinamika, ngjyra, pozita e elementeve, madhësia etj. |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të vëzhgojë më thellë mjedisin jetësor dhe të komentoj botën e gjallë dhe jo të gjallë;<br><br>2. Të vëzhgojë dhe bisedojë dhe shpreh mendimin për krijimet e artit figurative,ngjarjet e përditshme dhe të veçanta;<br><br>3. Të vëzhgojë dhe njehë dallimet midis vetës dhe midis të tjerëve;<br><br>4. Të njehë dhe t'i identifikojë mjetet dhe materialet e artit figurative;<br><br>5. Të identifikojë , interpretojë dhe praktikoj shenjat dhe simbolet në mjedisin jetësor;<br><br>6. Të vëzhgojë punën e krijuesve dhe të interpretuesve në mjedise autentike (atele , ekspozita,muze,biblioteka…etj.);<br><br>7. Të njeh e t'i kuptojë produktet e artit kombëtar dhe ti identifikojë artin e kulturave të tjera;<br><br>8. Të njeh dhe të gjykojnë për veçoritë në artin figurative;<br><br>9. Të njeh me terma të reja nga fusha e artit figurative dhe ti praktikojnë të njëjtat;<br><br>10. Të aftësohet për të gjykuar për të vëzhguarën dhe produktet e artit figurativ ; | Vazhdon aktivitetet e vëzhgimit të mjedisit jetësor dhe komenton në bazë të përceptimeve personale.<br><br>Bënë bisedë për krijimet e artit figurative, për ngajrjet e përditshme dhe të veçanta në këtë fushë.<br><br>Zhvillon aktivitetet të vëzhgimit për të dalluar tiparet midis vetës dhe të tjerëve dhe i shprehë ato në mënyrë figurative.<br><br>Bënë aktivitetet në të cilat emërton materialet dhe mjetet e artit figurative dhe përmes tyre bënë krijime figurative.<br><br>Vizaton, modelon etj. me mjete e materiale të llojllojshme.<br><br>Bënë shenja dhe simbole nga mjedisi jetësor dhe i vendos ato<br><br>Bënë aktivitetet figurative të lira dhe sipas modelit me materiale të ndryshme<br><br>Vizaton, modelon etj. përjetimet nga vëzhgimi i mjedisit jetësor<br><br>Gjykon për veçoritë në produktetet e artit figurative (tema, ngjyrërat, dinamika, etj.)<br><br>Ekspozon punimet figurative personale dhe të përbashkëta dhe bisedon për to | Vëzhgon mjedisin jetësor dhe komenton botën e gjallë dhe jo të gjallë<br><br>Vëzhgon dhe shpreh mendimet për krijimet e artit figurative, ngjarjet e përditshme dhe të veçanta në këtë fushë<br><br>Vëzhgon dhe njeh dallimet midis vetës dhe të tjerëve<br><br>Njeh dhe identifikon mjetetet dhe materialet e artit figurative<br><br>Njeh terma të reja nga fusha e artit figurative dhe të njejtat i aplikon<br><br>Identifikon, interpreton dhe praktikon shenja e simbole në mjedisin jetësor<br><br>Njeh punën e krijuesve dhe interpretuesve dhe prezentuesve të artit figurative në mjedise autentike (atele, punëtori, ekspozita, muze, biblioteka, festivale etj.)<br><br>Njeh e kupton produktet e artit kombëtar dhe identifikon artin e kulturave të tjera<br><br>Njeh dhe gjykon për veçoritë në krijimet figurative |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 11. Të zhvillojë përfytyrimet nga vëzhgimi i mjedisit jetësor dhe t'i shpreh figurativisht ato ;<br>12. Të kultivojë dhe të thellojë emocione pozitive për artin figurative duke ndjerë kënaqësi në aktivitete të artit;<br>13. Të krijojë produkte të artit –të vizatoj,modelojë me mjete e materiale të llojllojshme;<br>14. Të krijojë dhe shfrytëzojë shenjat e simbolet në jetën praktike. | Vëzhgon punën e krijuesve, interpretuesve të artit figurative në mjediset autentike dhe bisedon me ta.<br><br>Viziton ekspozitat e produkteve figurative të fëmijëve në institucionet parashkollore të tjera dhe bisedon për to dhe përmes krijimit figurative shpreh përshtypjet dhe përjetimet personale për to. | Shpreh figrativisht përfytyrimet nga mjesisi jetësor.<br><br>Manifeston kënaqësi dhe interes për aktivitetetete e artit figurative<br><br>Krijon produkte të artit-vizaton, modelon etj. me mjete e materiale të llojllojshme |

## IV. 3. 2 . 11. Integrimi ndërfushorë

Edukimi figurativ është fushë edukative e cila integrohet natyrshëm dhe në vazhdimsi me fushat e tjera të kurikulit parashkollor.

Aftësitë figurative të fëmijës parashkollor zhvillohen jo vetëm me aktivitetet figurative por edhe përmes aktivitetetve në fushat e tjera eduaktive, e duke i ndërlidhur me kontekstin jetësor të fëmijës.

Aktivitetet e ndryshme të fëmijës në natyrë dhe mjedisin jetësor (social) të tij , i mundësojnë të njoh tiparet e ndryshme të botës së gjallë dhe jo të gjallë si ngjyrën, formën, madhësinë, pozitat, dinamikën, simetrin,asimetrin etj.

Përrallat, tregimet, vjershat, librat e ilustruar etj. i japin hov imagjinatës figurative të fëmijë dhe i ofrojnë shanse t`i shprehë përjetimet personale në vizatim, modelim etj.

Këngët për fëmijë dhe të tjerat  për botën bimore e shtazore,  fëmijët i dëgjojnë, dhe i shprehin figurativisht përjetimet me çka plotësojnë përfytyrimet për botën dhe zhvillohen aftësitë figurative shprehëse

Edukimi fizik e shëndetësor i ofron mundësi fëmijës të zhvillojë ndjesinë e muskujve të imtë të gishtrinjëve të dorës dhe të tjera të trupit  si dhe të arrijë gjendjen fizike dhe disponim të nevojshme për aktivitetetin figurativ.

Shqiptimi i tingujve, fjalës dhe fjalisë ka mundësi të realizohet përmes bisedave të përbashkëta për  krijimet figurative- vizatimi, modelimi, mozaiku, konstruktimi, për ngjarjeve e përditshme apo të veçanta figurative.

Dramatizimi i teksteve letrare dhe jo letrare zhvillon përceptimin vizuel të fëmijës dhe frymëzon fëmijën për shprehje figurative të këtyre përmbajtjeve

Loja me kukulla e shoqëruar me muzikë adekuate mundëson përjetimin më të thellë të muzikës dhe lojës dhe nxitë modelimin figurative të lire dhe jo të lirë ( me model) të fëmijës

Lojrat me grupe fëmijësh, gjatë të cilave fëmijët formojnë rrethin,  lëvizin lartë – poshtë, pozicionohen para-pas, majtas-djathtas etj,  krijojnë shanse të favorshme që të edukohet jo vetëm vëzhgimi dhe përceptimi hapsinor i fëmijës, si aftësi vizuele, por , në atmosferë të këndshme, fëmija të njohë dhe kuptojë disa nocione matematike të nevojshme për edukimin fugurativ

Aktivitetetet e ndryshme fizike, gjuhsore, letrare, muzikore e matematike i mundësojnë fëmijës ta njoh vetë dhe botën dhe e nxisin atë të shpreh përceptimin dhe përjetimin  me aktivitetete të ndryshme figurative.

Integrimi ndërfushor, pra i edukimit figurativ dhe fushave të tjera edukative mundëson zhvillimin dhe edukimin më të natyrshëm e tërësorë të parashkollorit.

**Fusha e aktivitetit:**

## IV. IV. Hapsira, rregulla, përmasa (matematika)

### IV.4. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME GRUP MOSHA 3 – 6

1. Të zhvillojë aftësinë e të vërejturit dhe të hetojë lidhjet midis botës me matematikën (Përvojat që transformohen në operacione apo dukuri matematikore)

2. Të zhvillojë aftësitë për zgjidhjen dhe përshkrimin e zgjidhjes së mundshme të problemit në situata konkrete jetësore

3. Të zhvillojë aftësitë e të përceptuarit (senzomotorik) përmes të cilit njeh objektet dhe dukuritë në mjedisin jetësor

4. Të zhvillojë kuptimin dhe të shkathtësohet për përdorimin e shprehjeve matematike në biseda joformale dhe situatat konkrete jetësore
5. (shprehjet e operacioneve: bashkësi, grup, +, -, :, x etj.)

6. Të aftësohet në vëzhgimin dhe në të hetuarit e dukurive natyrore duke përdorur shprehje simbolike komplekse (koha, dita, vendi , hapsira etj.)

7. Përmes përvojës individuale të njohë e të kuptojë raportet-krahasimin sasiore

8. Të aftësohet për t`i kuptuar kushtëzimet shkak-pasojë (fillet e të menduarit logjik)

9. Të zhvillojë aftësinë për “leximin” dhe hulumtimin e informacioneve me tregues
10. grafik

11. Të zhvillojë aftësinë e komunikimit verbal – fjalorin matematikor

12. Të zhvillojë shkathtësitë (manipuluese) për përdorimin e mjeteve,objekteve e materialeve të tjera didaktike

13. Të zhvillojë pavarësinë në hulumtimin e objekteve e dukurive, duke përvetësuar përvoja të reja – shkathtësia e eksperimentimit aktiv gjatë procesit të njohjes me veçoritë e objekteve, dukurive etj.

14. Të zhvillojë aftësinë për abstrahimin –ndarja e ca veçorive të objekteve dhe gjeneralizimi (hetimi i ngjajshmërive, dallimi, grupimi, klasifikimi, vargëzimi, përgjithësimi dhe konkluzionet- përfundimet)

15. Të aftësohet për emërtimin e një gjasendi të veçantë në kuadër të një emrtimi të përbashkët të një grupi apo lloji të mjeteve, objekteve, gjësendeve etj.

16. Të zhvillojë aftësitë e orientimit dhe përceptimit real në hapsirë, rrafsh dhe kohë përceptimi real dhe përfytyrimin hapsinor i ngjarjeve që zhvillohen në hapsirë, kohë dhe dallimi i rrjedhës koronologjike të tyre

17. Të zhvillojë aftësitë për t`i vërejtur, krahasuar dhe diferencuar si dhe emërtuar format e figurat gjeometrike

18. Të zhvillojë njohuritë dhe kuptimet për masën e objektit dhe masën e njësisë matëse (masën, matjen)

19. Të vetëdijësohet në përceptimin dhe vlerësimin e produktit të punës së vet dhe në bashkëveprim me të tjerët- t`i përjetojë dhe t`i gëzohet rezultateve të veprimtarisë individuale dhe të grupit apo çiftit bashkëveprues.

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të nisë të nxënit e shprehjeve matematike -pak, shumë, lartë, poshtë, përpara, pas, i gjatë, i shkurtë, i madh i vogël, emrat e numrave e tj.<br><br>2. Nga emërimi i objekteve e gjasendeve të veçanta të aftësohet gradualisht të numrojë<br><br>3. Të aftësohet për të bërë dallimin midis numrit dhe numrimit | Fëmijët emërtojnë objekte e gjësende të mjedisit jetësor sipas dëshirës së vet,dhe me ndihmën e të rriturit i grumbullon ato duke i emëruar një nga një (topi, kukulla, peshku…etj).<br>I emërton objektet apo gjësendet duke iu ndërruar vendin një nga një.<br>Numëron objektet e ngjashme sipas një veçorie (ngjyrës, formës, madhësisë,…).<br>Numëron mjetet të cilat veçohen për kah sasia (cilat janë më shumë ; cilat janë më pak)<br>Numëron gjësendet e radhitura (thuprat,shkallët kur ecë nëpër to,hapat,guralecët…etj.)<br>Numëron gjësendet e të cilat nuk janë të radhitura me një rend ë caktuar(pikat e shiut, lulet në kopsht,lodrat në një grumbull,rretë në qiell,anëtarët e familjes në fotografi..etj.).<br>Numëron gishtat e dorës dhe luan me hijet e tyre.<br>Krijon grumbull(bashkësi) të madh të objekteve,gjësendeve dhe i vëzhgon ato sa janë bërë të mëdha.<br>Krijon disa bashkësi të madha të objekteve me elemente të njëjta dhe i vëzhgon ato sa janë bërë të mëdha dhe çka ka mbetur.<br>Krijon grumbull,dhe objektet gjësendet i bashkon sipas disa cilësive (të mëdhatë,të verdhat,të gjatat,të fortat..etj).<br>Ndan bashkësinë e objekteve në dy apo disa grupe. | Njeh shprehjevet matematike -pak, shumë, lartë, poshtë, përpara, pas, i gjatë, i shkurtë, i madh i vogël, emrat e numrave e tj.<br><br>Eshtë në gjendje të numrojë<br><br>Bënë dallimin midis numrit dhe numrimit<br><br>Njeh raportet një me një dhe një pas një |

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 4. Të njeh raportet një me një dhe një pas një.<br><br>5. Të zhvillojë operacione logjike si bazë për mbledhje dhe zbritje<br><br>6. Të aftësohet për identifikikimin dhe dallimin e gjasendeve sipas ngjyrave | Bënë radhitjen e objekteve një nga një.<br>Radhitë objekte sipas raportit një me një ;sipas këtij raporti bënë ndarjen midis objekteve, njerëzve, lodrave...etj.(një lodër një fëmijë, një pjatë –një fëmijë..etj).<br>Bënë radhitjen e lodrave,..sipas modelit,sipas madhësisë nga e madhja te e vogla dhe, në të kundërtën.<br>Fiton përvojë për renditjen e detyrave,obligimeve të vogla;renditja e rrobave që do ti veshë,pajisjet e nevojëshme për të vizatuar..etj.<br>Luan me fëmijë dhe të rritur lojëra- një mua e një për ty…etj.<br>Luan lojëra ku vihet në pozita dhe raporte të ndryshme hapësinore: përpara, anash,në mes,djathtas, majtas, latë, poshtë..etj.<br>Fëmija me trupin e vet mëson domethënien e djathtë,e majtë, sipër, përpara..etj.<br>Vëzhgon dhe shpjegon rendin e ngjarjeve të përjetuara në situate konkrete dhe njeh shprehjet më parë,pastaj,tani,të nesërmen,herën e fundit..etj.<br>Bisedon dhe përpiqet të sqaroj raportet shkak-pasojë në situate konkrete apo të treguara nga i rrituri(çka ka ndodhur së pari si shkak dhe çka është bërë si pasojë.) Pse-të e fëmijës!<br>Luan me lodra konstruktive,nga pjesët e vogla të lodrave krijon tërësinë dhe në të kundërtën. | Bënë operacione logjike si bazë për mbledhje dhe zbritje<br><br>Identifikikon dhe dallon gjasendet sipas ngjyrave<br><br>Identifikon dhe dallonë objektet sipas formës dhe vetive<br><br>Krijon bashkësitë e gjasendeve apo gjallesave<br><br>Numëron elementet e bashkësisë. |

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 7. Të identifikojë dhe dallojë objektet sipas formës dhe vetive<br><br>8. Të krijojë bashkësitë e gjësendeve apo gjallesave<br><br>9. Të aftësohet t`i numërojë elementet e bashkësis<br><br>10. Të aftësohet t`i identifikojë dhe karahasojë bashkësitë sipas vetive të caktuara.<br><br>11. Të ketë të zhvilluar ndjeshmëri pët t`u orientuar në kohë dhe haspirë.<br><br>12. Të njeh marrëdhëniet midis shkakut dhe pasojës. | Luan me figura dhe trupa gjeometrik dhe kërkon forma të njëjta në natyrë,ato i emëron, i modelon dhe i vizaton.<br>Bisedon me të tjerët për karakteristikat fizike dhe gjeometrike të objekteve gjësendeve(ngjyrën,formën,sipërfaqen,madhësinë, pozitën p.sh.e rrumbullakët,e drejtë,me kënde,e butë,e lëngët, e madhe,poshtë,mbi,krahu i djathtë..etj.).<br>Vëzhgon simetrinë e mjeteve në natyrë,krijon,vizaton figura simetrike.<br>Luan me mjete të cilësive të ndryshme,i krahason ato në bazë të pamjes së jashtme dhe sipas përmbajtjes(enë të njëjta me përmbajtje të ndryshme,ngjyra të ndryshme me të njëjtat pjata,sheqerka të ndryshme me ambalazhe të ndryshme..etj).<br>Gjatë krahasimit të objekteve sipas karakteristikave gjeometrike praktikon shprehjet matematike si:më pak më shumë,më i lartë, më i gjerë,më i mëreftë…etj.<br>Luan me peshore, menzura e mjete të tjera për matj metri, peshorja, lugë, lopata, enë të tejdukshme…etj.<br>Bënë numërimin e mbushjes në enë,krahason sa qumësht ka në gotë në krahasim me gotën e fëmijës tjetër…etj. | Identifikon dhe karahason bashkësitë sipas vetive të caktuara<br><br>Tregon ndejsi për orientim në kohë dhe haspirë<br><br>Njeh marrëdhëniet midis shkakut dhe pasojës. |

**GRUP-MOSHA 3-4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
| --- | --- | --- |
| 13. Të aftësohet t`shfrytëzojë mundësitë e ndryshme për t`i zgjidhë situatat problemore. | Fiton një përvojë për vlerësimin e rezultateve të punës së vet dhe krahason veprimet e tij me të tjerët. Bënë plan dhe parashikon se çfarë rezultati pret. | Shfrytëzonë mundësitë e ndryshme për t`i zgjidhë situatat problemore |

## GRUP-MOSHA 4-5

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të pasurojë dhe zgjerojë shprehjet matematike<br><br>2. Të numrojë elementet (gjasendet, frymorët etj.) në bashkësi dhe t`i krahasojë gjatë numrimit<br><br>3. Të krahasojë elementet në bazë të lartësisë, gjerësisë, gjatësisë, peshës etj.<br><br>4. Të vërejë dhe dallojë sasinë e elementeve në bashkësi<br><br>5. Të caktojë pozitën e një elementi ndaj elementit tjetër<br><br>6. Të kuptojë dallimin midis numrit dhe numrimit | Në situata të përditshme jetësore fiton përvojë për emërtimin shfrytëzimin e termave matematike.<br>Luan me mjete të ndryshme duke i emëruar ato dhe shfrytëzon shprehje matematike gjatë rregullimit të tyre në grupe të veçanta<br>Emëron dhe bënë seleksionimin e elementeve prej elementeve tjerë në grup sipas disa cilësive.<br>Numëron gjësendet e ngjashme në mjedisin jetësor(karigat,lulet,gjethet…etj).<br>Numëron gjësendet sipas sasisë-cilat janë më pak dhe ato më shumë.<br>Numëron në mënyrë sukseseve dhe zbrapthi (1,2,3…:3,2,1,): numëron më nga dy,tre..:llogaritë.<br>Luan me makinë llogaritëse dhe me objekte të tjera në të cilat janë të shënuara numërorët(telefoni,peshorja,termometri,…etj.),I njohin ato i emërojnë dhe fitojnë përvojë për domethënien e tyre.<br>Radhitë objekte sipas numrit rendorë:I pari, I dyti I treti,I katërti…etj.dhe, i krahason me objektet të cilat nuk janë të radhitura-një,dy,tre…etj. si dhe analizon e krahason rezultatet e këtyre dy aktiviteteve.<br>Numëron mjetet në grup duke I ndarë ato në grupe të vogla ,të njëjtat I numëron(ngjyrat në buqetën e luleve). | Ka fjalorë të pasur dhe të gjerë.<br><br>Numëron elementet (gjasendet, frymorët etj) në bashkësi dhe i krahason gjatë numërimit.<br><br>Krahason elementet në bazë të lartësisë, gjerësisë, gjatësisë, peshës etj.<br><br>Vëren dhe dallon sasinë e elementeve në bashkësi.<br><br>Cakton pozitën e një elementi ndaj elementit tjetër.<br><br>Kupton dallimin midis numrit dhe numërimit. |

## GRUP-MOSHA 4-5

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 7. Të kuptojë raportet midis numrave<br><br>8. Të kuptojë veprimet e mbledhjes dhe zbritjes<br><br>9. Të krahasojë bashkësitë të cilat dallojë për një apo më shumë elemente<br><br>10. Të identifikojë dhe dallojë objektet dhe gjasendet sipas vetive të tyre (ngjyra, sasia, forma etj.)<br><br>11. Të orientohet në hapsirë dhe kohë | Numëron objektet dhe gjësendet të cilat i gjenden në mjedisin jetësor si dhe ato të cilat nuk janë afër tij (pikturat në mure, personat në fotografi…etj.)<br>Numëron me gishtërit dhe luan duke munguar e shtuar për të arrit një rezultat matematik.<br>Ndan grupin e objekteve në dy apo më shumë grupe të njëjta dhe shef se prej sa elementesh këto grupe përbëhen dhe çka ka mbetur.<br>Radhitë objektet në raport një me një, zbulon kuptimin e këtij raporti dhe rëndësinë e saj në praktikë(ndarja e lodrave fëmijëve1-1;përgatitja e tryezës për ushëim1pjatë-një fëmijë …etj).<br>Shpërndan objektet me radhë një pas një,në qifte,në treshe ..etj.<br>Klasifikon gjësendet në grupe sipas llojit dhe cilësive të caktuara.<br>Luan me lodra të cilat I zbërthen dhe I monton duke I transformuar në forma të reja.<br>Numëron gjësende duke shtuar dhe munguar nga një.<br>Luan lojëra shoqëruese,të cilat përmbajnë numërime(domino,katrorë me numërorë që vehet në lëvizje…etj.<br>Dialogon për veprimet e përditshme,bënë pyetje si:sa lugë mungojnë në tryezë:edhe sa lugë nevojiten për të pirë supën të gjithë,pra në veprimet e përditshmërisë realizon mbledhjen dhe zbritjen.<br>Bisedon me të tjerët për zgjidhjet e veta të ndonjë problemi situativ dhe i vlerëson rezultatet e veta. | Kupton raportet midis numrave.<br><br>Kupton veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.<br><br>Krahason bashkësitë të cilat dallojnë për një apo më shumë elemente.<br><br>Identifikon dhe dallon objektet dhe gjësendet sipas vetive të tyre ( ngjyra sasia forma etj).<br><br>Orientohet në hapsirë dhe kohë.<br><br>Ka kuptim të zgjeruar për marrëdhëniet shkak-pasojë. |

**GRUP-MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 12. Të thellojë dhe zgjerojë kuptimin për marrëdhënjet shkak-pasoj<br><br>13. Të aftësohet për t`i shfrytëzuar mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së problemeve<br><br>14. Të aftësohet për t`i krahasuar rezultatet gjatë llogaritjeve<br><br>15. Të vetëvlerësojë veprimet e ndryshme matematike | Vëzhgon dhe i komenton rezultatet e të tjerëve-se sa objekte ata i kanë;sa më shumë e sa më pak.<br>Vizaton simbole për vetën e vet,për kopsht,llojet e lodrave për këndin e leximit, shenjat e trafikut. shenjën në dollap..etj, dhe bisedon për rëndësinë e tyre.<br>Bënë paraqitjen tabelore të simboleve-sa prej shoqeve kanë fustane të kuqë;sa shokë mungojnë atë ditë;sa fëmijë kanë ditëlindjen…etj dhe vendosë simbolin në kalendarë.<br>Përpilon kalendarin ,dhe, çdo ditë e vëzhgon datën ,ditën,,muajin duke manipuluar dhe vendosur simbolet për kushtet atmosferike në ditën konkrete.<br>Komenton simbolet në tabelë,i përpunon ato dhe, rezultatet e përpunuara ua prezanton të tjerëve.<br>Bisedon për radhitjen e ngjarjeve në hapësirë dhe kohë.<br>Bisedon çka ka ndodhur së pari si arsye dhe çka është si pasojë e saj.<br>Luan lojëra me pyetje dhe përgjigje, të cilat fillojnë me pse?<br>Parashikon rezultatet e ndonjë tregimi,përralle apo ngjarje e loje.(p.sh.edhe sa lodra na duhen për ta organizuar lojën…).<br>Bisedon për ndonjë dukuri apo ngjarje që ka ndodhur disa herë dhe njehson shumën e tyre.<br>Vëzhgon dhe mendon për mundësitë e zgjidhjes së të njejtit problem në mënyra të ndryshme.<br>Komenton rezultatin me të tjerët dhe bënë vlerësimin e veprimeve të tij duke manifestuar gëzim . | Shfrytëzon mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së problemeve.<br><br>Krahason rezultatet gjatë llogaritjeve.<br><br>Vetëvlerëson veprimet e ndryshme matematike. |

## GRUP-MOSHA 5-6

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1.Të aftësohet të formësojë materiali matematik dhe të krijohen shprehi të shfrytëzimit të tij. | Sendërton dhe fillon të sistematizojë përvojën e fituar nga matematika duke u shërbyer me fjalor dhe shprehje matematike. Shkathtësohet dhe krijon shprehitë për shfrytëzimin e shprehjeve matematike gjatë aktiviteteve krijimit të bashkësive dhe rregullimit të tyre në grupe të veçanta duke respektuar disa cilësi të elementeve.(topi-edhe një top me ngjyrë të kuq…) Luan me objekte të ndryshme, i emëron ato dhe i nëngrupon sipas disa karakteristikave të veçanta. | Ka fjalor të pasur matematik dhe ka të krijuara shprehi të shfrytëzimit të tij |
| 2. Të numërojë elementet në bashkësi më të mëdha dhe t'i krahasojë gjatë numërimit. | Numëron objektet e ngjashme të mjedisit jetësor (lapsat, gomat, karigat…)dhe bënë dallimin midis tyre sipas disa cilësive(lapsat-kanë madhësi,ngjyrë,gjatësi të ndryshme Numëron objektet sipas sasisë-më shumë ,më pak,më pak se,nëse atëherë…. | Numron elementet në bashkësi më të mëdha dhe i krahasojë gjatë numrimit |
| 3. Të aftësohet për të kuptuar unionin (bashkimin) e bashkësive dhe ndarjen e tyre sipas ngjyrës, llojit të materialit, formës etj. | Bënë numërimin në mënyrë suksesive dhe zbrapthi;numëron me numëror qift dhe tek;numëron1,2,3,…duke shtuar e duke pakësuar. Bënë aktivitete me makina llogaritëse dhe me mjete të tjera në të cilat janë të shënuara numërorët (telefoni,termometri,peshorja),I njohin ato,i emëron dhe fillojnë ta kuptoj domethënien e tyre. | Kupton unionin (bashkimin) e bashkësive dhe ndarjen e tyre sipas ngjyrës, llojit të materjalit, formës etj. |
| 4. Të jetë në gjendje të krahasojë bashkësinë në bazë të numrit të elementeve, ngjyrës, formës, madhësisë etj. | Objektet e paorganizuara i radhitë, duke shfrytëzuar shprehje matematike si:i pari ,i dyti, i treti,…etj. Duke luajtur me objekte të ndryshme përpiqet të bënë dallimin midis aktiviteteve me shprehjet matematike, si :i pari – një; i dyti-dy; i treti-tre; | Karahason bashkësinë në bazë të numrit të elementeve, ngjyrës, fromës, madhësisë etj. |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 5. Të dallojë gjësendet e njëjta në bashkësinë (grumbullin) e disa gjësendeve. | Numëron elementet e një bashkësie duke i ndarë në bashkësi më të vogla dhe, llogaritë rezultatin e tyre.(janë gjithësejt 5 lule; 6 lapsa…etj)<br>Bënë simbole të ndryshme për të identifikuar të vetën,kohën,vendin,këndin e leximit,shenjat e trafikut…etj<br>Luan dhe rregullon çdo ditë kalendarin duke vënë simbole për të veçantat e ditës konkrete. | Dallon materialet sipas madhësisë, peshës dhe i krahasonë rezultatet gjatë matjeve. |
| 6. Të orientohet në natyrë në raport me objektet me të cilat janë të rrethuar. | Numëron objekte e gjëra të tjera të cilat nuk mund ti prekë dhe kap-pikturat,fotografi,ilustracione e pikturat ndryshme.<br>Luan me lodra dhe i ndanë në dy apo më shumë grupe më elemente të njëjta.,i numëron elementet e tyre dhe konstaton prej sa elementeve përmbahen dhe sa është mbetja. | Dallon gjësendet e njejta në bashkësinë (grumbullin) e disa gjasendeve<br><br>Orientohet në natyrë në raport me objektet me të cilat janë të rrethuar |
| 7. Të orientohet në hapsirë dhe kohë. | Gatë përditshmërisë praktikon marrëdhëniet në raporte si:një me një; dy me një;…etj.<br>Shpërndanë lodrat sipas radhës një pas një;në qifte;duke respektuar një kriter.(sipas një cilësie të caktuar).<br>Luan me lodra konstruktive , zbërthen dhe monton duke konstruktuar e rikonstruktuar forma e figura të reja. | Orientohet në hapsirë dhe kohë |
| 8. Të kryejë matje të figurave dhe të krahasojnë rezultatet gjatë matjeve. | Parashikon dhe bisedon me moshatarë për planin e veprimit dhe zgjidhjet e ndonjë problemi konkret dhe vlerëson rezultate veta dhe të tjerëve.<br>Vlerëson dhe komenton rezultatet e të tjerëve-sa mjete ata i kanë;sa kanë më shumë e sa më pak. | Kryenë matje të figurave dhe krahasonë rezultatet gjatë matjeve<br><br>Njeh trupat gjeometrik-kubin, sferën, piramidën etj. |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 9. Të njeh trupat gjeometrik kubin, sferën, piramidën etj.<br><br>10. Të kuptojë simetrinë dhe të krijojë figura simetrike<br><br>11. Të dallojë objektet simetrike dhe asimetrike në natyrë 12. Të thellonë e zgjerojnë më tutje kuptimin për marrëdhëniet shkak-pasojë.<br><br>13. Të aftësohet për zhgjedhjen e të njëjtit problem në mënyra të ndryshme.<br><br>14. Të aftësohet për t'i krahasuar rezultatet gjatë llogaritjeve. | Luan me objekte e gjësende të ndryshme duke I vënë në pozicione të ndryshme.(brenda dhe jashtë kutisë;para apo pas një objekti;krahason gjërat në bazë të pamjes së jashtme dhe përmbajtjes.(enë të njëjta me përmbajtje të ndryshme dhe e kundërta).<br>Mëson për pozicionet e ndërtesave dhe bënë krahasime,vizaton planin sipas kujtesës dhe ideve të tij.<br>Modelon makete të ndërtesave dhe reliefë të mjedisit jetësor si dhe projekton harta sipas modelit apo kujtesës.<br>Luan lojëra sipas rregullave të parapara(të pozicionohet përpara bankës,mbrapa karigës në anë të djathtë, nën tavolinë…etj.<br>Bënë seleksionimin e klasifikimin sipas disa kritereve si:pamjes, përmbajtjes,sasisë,cilësisë.<br>Bënë dallimin dhe krahason elementet e grupit sipas di sa cilësive si:madhësisë,formës, ngjyrës,sasisë…etj.<br>Punon sipas modelit të caktuar paraprak,dhe sipas idesë së imagjinuar.<br>Bënë matje me veprime e pajisje të përshtatshme (me hapa, kërcim, pëllëmbë të dorës, shkop, gota, lugë,…etj.)dhe luan me masa-peshore,termometër,metri i rrobaqepësisë,enë të tejdukshme , vizore etj. | Kupton simetrinë dhe të krijojnë figura simetrike<br><br>Dallonë objektet simetrike dhe asimetrike në natyrë<br><br>Ka kuptim më të gjerë e më të thellë për marrëdhëniet shkak- pasojë<br><br>Zgjidh problemin e njejtë në mënyra të ndryshme<br><br>Krahason rezultatet gjatë llogaritjeve |

**GRUP-MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 15. Të aftësohet për t'i krahasuar rezultatet gjatë llogaritjeve 16. Të aftësohet për t'i vlerësuar dhe sipas nevojës korigjon veprimet e ndryshme matematikore. | Luan lojëra tematike si:shitorja,tregu,kuzhina,banka…etj. Regjistron të dhënat e matjeve në mënyrë grafike e tabelore dhe bënë krahasime me rezultatet e moshatarëve të tjerë.<br>Vetë vlerëson veprimet e bëra dhe krijon shprehi për ti vlerësuar edhe rezultatet e të tjerëve. | Vetëvlerësonë dhe sipas nevojës korigjonë veprimet e ndryshme matematike. |

## Integrimi ndërfushorë

Aktivitetet në fushën e matematikës nuk janë aktivitete të pavarura por ato janë të ndërlidhura e të ndërthura me fusha të tjera të kurikulit.
Duke u mbështetur në interesat dhe mundësitë e fëmijës fusha e matematikës realizohet më me sukses nëse përmbajtjet e përditshmërisë jetësore ndërlidhen natyrshëm më shprehjet dhe veprimtaritë matematike. të fëmijës.

Fusha e matematikës ka mundësi të mëdha të integrohet me aktivitetet e edukatës fizike dhe shëndetësore.
Përmbajtjet e veprimtarive të edukimit fizik dhe shëndetësor si : ecja me hapa të vegjël dhe të mëdha ; radhitja në rresht, me nga një ,dy, numërimi i pari , i dyti… me radhë …; kërcimi më lartësi e gjatësi të ndryshme; lojërat në grupe,formimi i grupeve nga një bashkësi më e madhe e fëmijëve për të luajtur lojëra me mjete të ndryshme si :topi, litari rrethorët, thuprat e gjatësive dhe të ngjyrave të llojllojshme,formimi i rrethit me fëmijët për të luajtur lojëra me top në raport një me një ;klasifikimi i rezultateve sipas pikëve;paraqitja tabelore e rezultateve; lojëra me topa bore,noti-krahu i djathtë dhe i majtë e shumë aktivitete të tjera, ofrojnë mundësi të shumëfishta për tu integruar në veprimtaritë matematike. Këto aktivitete të mundshme si dhe shumë të tjera me përmbajtje matematike, krijojnë rrethana të favorshme që fëmija parashkollor t"i njeh, zhvilloj dhe të familjarizohet më fjalorin matematik si dhe, të kuptojë e zhvillojë nocionet fillestare matematike.

Diskutimet në aktivitetet e gjuhës, përshkrimi i përvojave, alfabeti i gjuhës , vjershat ,tregimet,përrallat, librat e ilustruar me figura dhe trupa gjeometrik dhe numërorë të ngjyrosura me ngjyra ...etj janë burime të përshtatshme të cilat realizojnë integrim të natyrshëm me përmbajtjet e aktiviteteve matematike.Në tregimin e një ngjarje sipas kronologjisë dhe vendit të zhvillimit fëmijët kanë mundësi të njohin dhe të perceptojnë kohën ,vendin dhe hapësirën ku është zhvilluar ngjarja. Gjithashtu,numri i personazheve në përrallë apo në ndonjë tregim, ofron shanse për të numëruar dhe për ti kuptuar raportet midis tyre(sa personazhe ishin;cili ishte më i gjatë e cili më i shkurtër;sa mollë ia dha ;edhe sa i mbetën ;cili ishte i pari,po i treti;kush ishte para tij; ishin të bashkuar e më vonë u ndanë në disa grupe; cili mbeti vetëm …etj. Këto sekuenca të prezantuara si shembuj të mundshëm në fushën e gjuhës pasurojnë përmbajtjet dhe integrohen më lehtë në aktivitetet matematike.

Aktivitetet matematike ofrojnë kënaqësi dhe realizohen me sukses kur integrohen e ndërthuren me mjedisin e kontekstin jetësor të fëmijës. Njohja e vetës dhe e botës është një fushë që ofron përmbajtje të begatshme për të mësuar matematikë.Vet trupi i fëmijës me gjymtyrë të fëmijës,natyra me tërë botën e gjallë dhe jot ë gjallë,njerëzit,bota bimore e shtazore,rëra,guralecët,balta,letra,e shumë të tjera .janë pjesë integrale të aktiviteteve në fushën e matematikës. Këto janë premisa mbi të cilat realizohet vëzhgimi, perceptimi, të hetuarit,analiza,sinteza,krahasimi, sintetizimi klasifikimi,induksioni, deduksioni..., operacione këto të cilat edukojnë të menduarit logjik-matematik.

Njohja dhe zhvillimi i të menduarit matematik, ndjeshmëria dhe shkathtësitë në aktivitete matematike,integrohen në mënyrë të mrekullueshme me botën e fëmijës nëpërmjet artit figurativ dhe atë muzikor .Integrimi i natyrshëm midis këtyre fushave krijon kushte të volitshme që fëmijët të familjarizohen me botën e matematikës pa

krijuar frikë e ankth (nga matematika),emocione këto të cilat shpesh herë lënë pasoja gjatë jetës. Vizatimi dhe ngjyrosja në tema të ndryshme nga jeta ,modelimi ,kolazhet,...etj ofrojnë mundësi të shumëfishta për të ngacmuar shpirtin e një “matematicienti” të ardhshëm. Njohja me ngjyrat,dallimi dhe krahasimi i tyre (relacionet) ,numërimi, seleksionimi dhe klasifikimi si shprehje(operacione) matematike gërshetohen dendur dhe gjejnë aplikim në fushën e matematikës. Vizatimi i vijave në formë e gjatësi të ndryshme si:vijë e drejtë;e lakuar ;e pjerrët,e hapur ,e mbyllur,rrethore dhe i figurave e trupave të llojllojshëm gjeometrik krijojnë truall për zhvillimin e mëtejmë të koncepteve bazë. Shkathtësia e manipulimit dhe modelimit me materiale dhe mjete të llojllojshme në fushën e artit figurativ, mundëson njohjen e tyre ,pasurimin e fjalorit si dhe perceptimin e formave të ndryshme gjeometrike. Pikturimi në pëlhurë jo vetëm që ngjallë emocione të këndshme por njëherit krijon mundësi për perceptimin e hapësirës dhe pozitës së objekteve e trupave dhe relacionet midis tyre.

Përmbajtjet e këngëve ,lojërat ritmike,vallëzimi..etj përmbajnë përmbajtje sasiore dhe cilësore të cilat gërshetohen me matematikën. Ritmi në vallëzim dhe numri i hapave gjatë një loje ritmike,kahet e lëvizjes .përsëritja e tyre, lojëra me mjete e instrumente të ndryshme, ofrojnë përvetësimin e shumë njohurive në fushën e matematikës. Aktivitetet si:,kërcimi në radhë,në qift, një pas një,njeri para tjetrit në rrathë,në kahe të djathtë e të majtë...etj. janë veprime të cilat mishërohen me njohjen dhe përjetimin e kuptimeve matematike. Lozja në instrumente muzikore me tinguj të ndryshëm amplitude të ndryshme të cilat mundë të numërohen, të identifikohen për kah gjatësia dhe të përsëriten, gjithashtu realizojnë integrimin ndërfushor me matematikën.

**FUSHA E AKTIVITETIT:**

## IV. V. NJOHJA E VETËS DHE BOTËS

## IV.4. 1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME GRUP MOSHA 3 – 6

1. Të zhvillohet kërshëria për njohjen e vetës dhe botës
2. Të njoh vetën- kush jam dhe çfarë mund të bëjë
3. Të zhvillohet siguria, pavarësia në shprehje dhe sjellje -autonomia e personalitetit
4. Të njoh, vendosë dhe forcojë relacionet dhe komunikimin me mjedisin jetësor (sociale e të tjerë)
5. Të njoh nevojën dhe mundësinë e mbrojtjes dhe të shkathtësohet ta mbrojë vetën dhe të tjerët
6. Të mësohet të vlerësojë dhe respektojnë mjedisin jetësor (botën e gjallë dhe jo të gjallë)
7. Të zhvillojë ndjenjën se i përket mjedisit jetësor
8. Të njeh, vlerësojë dhe respektojë mjediset e kulturat e tjera- ndryshe nga e vetja
9. Të zhvillohen aftësitë krijuese
10. Të zhvillohet sensi për vetkritik dhe kritik

**GRUP MOSHA 3 – 4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të inkurajohet dëshira, nevoja dhe kërshëria për njohjen e vetës dhe botës<br><br>2. Të krijojë situata jetësore për nxitjen dhe zhvillimin e kërshërisë për njohjen e vetës dhe botës<br><br>3. Të mbështeten, nxiten dhe inkurajohen pse-të dhe të vehet në situata të marrë apo zbulon përgjegjet.<br><br>4. Të nxitet e aftësohet për njohjen e identitetit personal (emri, mbiemri, mosha, gjinia, përkatësia familjare etj.)<br><br>5. Ti formësojë përfytyrimet për atë që mund të bëjnë për vetën dhe mjedisin jetësor<br><br>6. Të kultivojë imagjinatën dhe aftësitë e të shprehurit me lëvizje dhe fjalë<br><br>7. Të hetojë, njoh e kuptojë emocionet e veta dhe të tjerëve dhe të zhvillojë aftësinë e bashkëndjesisë | Në aktivitete të përditshme vëzhgon dhe njihen me trupin e vet dhe aftësitë e veta;<br>Në aktivitete studion trupin e vet dhe funksionimin e tij (gjatë ushqimit studion si i ndihmojnë sytë, hunda, këmbët, dhe duart,si të sjellë ushqimin në gojë...etj.)<br>Përjeton ndijimet e veçanta shqisore si:dëgjon, nuhatë, shijon, prekë,përcakton se nga frynë era dhe, njeh funksionin e tyre( p.sh. shqisat e njoftojnë para rrezikut,muskujt i ndihmojnë në lëvizje,si të largohet nga rreziku,…etj).<br>Aktivitete përmes lojërave të ndryshme të qëllojnë sipas shijes,erës,madhësisë,formës,…etj.;<br>Ushtron ndijimin e të prekurit duke prekur e qëlluar prej cilit material është ndërtuar objekti;<br>Bënë aktivitete konstruktive në të cilat fëmija përjeton suksesin e vet dhe ka rast të ndiejë kënaqësi në to.(formon qëndrim pozitiv për vetën);<br>Zhvillon aktivitete të imitimit simbolik,përkatësisht paramendon vetën në ndonjë situatë jetësore ku demonstron ndjenjën e rritjes së besimit dhe sigurisë në vete;<br>Bënë aktivitete për tu angazhuar në periudha më të gjata kohore dhe sfidohen në aktivitetin konkret.(provojnë mundësitë të dhe aftësitë e tyre);<br>Bisedon për vështirësitë,konfliktet dhe përparësitë me të tjerët me qëllimtë identifikimit të ndjenjës pozitive dhe negative; | Shpreh dëshirën dhe kërshërinë për njohjen e vetës dhe botës.<br><br>Guxon të pyes dhe kërkon përgjegje nga të tjerët ose orvatet të gjejë përgjegjën.<br><br>Njoh emri, mbiemri, mosha, gjinia, përkatësia familjare etj.<br><br>Bënë veprime për vetën dhe për mjedisin jetësor.<br><br>Eshtë në gjendje të shprehë imagjinatën e tij me lëvizje dhe fjalë.<br><br>I heton, njeh e kupton emocionet e veta dhe të tjerëve dhe bashkëndjen me të tjerët.<br><br>Shpreh qëndrimet e veta. |

## GRUP MOSHA 3 – 4

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 8. Të nisë t`i zhvillojë dhe të shprehë qëndrimet e veta<br><br>9. Të aftësohet për t`u identifikuar me personat dhe personazhet pozitiv(nga familja, mjedisi social jashtë familjar, në përmbajtjet artistike, as-media etj.)<br><br>10. Të aftësohet t`i gjykojë sjelljet negative personale apo sjelljet e shembujt negativ në mjedisin jetësorë<br><br>11. Të zhvillojë siguria dhe vetëbesimi<br><br>12. Të nisë të shkathtësohet për t`u përballur me situatatat jetësore ta mbroj vetën dhe të tjerët.<br><br>13. Të aftësohet të përfundojë detyrën e filluar,<br><br>14. Të njoh e ta kuptojë varësinë reciproke të tij dhe të mjedisit jetësor | Të zhvillojë diskutime me pyetje … për ekzistencën e tij, lindjes së tij, vdekjes,ciklet e jetës etj;<br>Bënë aktivitete në të cilat identifikohen, kuptojnë e respektojnë gjininë e vet dhe aftësitë e veta;(tregojnë emrin e tyre të plotë, përdorin shkathtësitë adekuate sociale pa dallim gjinorë);<br>Luan lojëra simbolike me role për tu identifikuar me persona e personazhe pozitive të mjedisit jetësor (përvetëson modele të sjelljes dhe jetës së përbashkët,mëson role dhe profesione shoqërore,"bëhet" mjek, edukatorë, nënë…etj.);<br>Aktivitete ku mësojnë për shëndetin e vet, sigurinë dhe parandalimin nga lëndimet;<br>Aktivitete në të cilat shfrytëzon shqisat,përkatësisht shqisën e shijes duke vënë theksin që mos të konsumohen gjëra helmuese të cilat dëmtojnë shëndetin;<br>Aktivitete ku fitojnë eksperiencë për gjallesat shumë të vogla apo të padukshme me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe higjienës së duarve dhe dhëmbëve ;<br>Luan lojëra të ndryshme si:këngë,shaka,gjëegjëza,barsoleta përralla të cilat i kanë përjetuar gjeneratat e mëparshme.(njihet me kulturat e njerëzimit në kohën e mëparshme);<br>Bëjnë vizita, ekskursione dhe përmes tregimeve, ilustrimeve etj, njihen me komunitetin e afërt, njihet me bibliotekën, teatrin, shkollën, spitalin, postën etj.; | Tregon shenja të identifikimit me personat dhe personazhet pozitiv (nga familja, mjedisi social jashtë familjar, në përmbajtjet artistike, mas-mediat etj.)<br><br>Gjykon sjelljet negative personale apo sjelljet e shembujt negativ në mjedisin jetësorë.<br><br>Tregon shenja të siguriasë dhe vetbesimit.<br><br>Tenton të mbrojnë vetën dhe të tjerët.<br><br>Përfundon detyrën e filluar.<br><br>Njeh dhe kupton varësinë reciproke të tij dhe të mjedisit jetësor. |

## GRUP MOSHA 3 – 4

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 15. Të ketë përgjegjësi për fjalën, sjelljet dhe veprimet e veta<br><br>16. T`i njoh dhe t`i kuptojë sjelljet e pranueshme dhe të papranueshme në mjedisin jetësor dhe të sillet konform tyre<br><br>17. Të zhvillojë kuptimin dhe vlerësimin e ndjenjave dhe pikëpamjeve të të tjerëve<br><br>18. Të zhvillojë kuptimin e të drejtave të veta dhe të tjerëve dhe t`i respektojë ato<br><br>19. Të kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ta kultivojë atë.<br><br>20. Të zhvillojë interesin për botën bimore dhe shtazore | Bisedon për familjen e vet dhe atë që njeh ku ka mundësi të shpreh përjetimet e veta e të njeh mënyra të ndryshme jetësore në familje:<br>Bashkëpunon në përgatitjen dhe planifikimin e festave të ndryshme duke i respektuar dallimet e kulturave të ndryshme;<br>Bisedon e diskuton për sjelljet e përgjegjshme për afirmimin e individualitetit të tyre;(për veshje ,muzikë, respektimin e jetës private, bindjeve,nevojave të shokut…etj.);<br>Zhvillon aktivitete jo diskriminuese në të cilat mundësohet zhvillimi i ndjenjës së sigurisë dhe asaj sociale(gjinia,prejardhja sociale dhe kulturore,fesë,konstruksionit trupor,…etj.);<br>Të zhvillojë aktivitete në të cilat mësojnë rregullat e sjelljes së kulturuar.(të mos i pengon tjetrit,të respektojë autonominë e individit ,të këtë qëndrim dhe vendosje autonome, ndarje të përgjegjësive për vendimet e ndërmarra së bashku…etj);<br>Bën shëtitje në natyrë dhe viziton kopshtin zoologjik, parkun, fushat pjellore ,pyllin,…etj ku vëzhgojnë, kërkojnë, krahasojnë, kujdesen dhe mirëmbajnë bimët dhe shtazët në mjedisin e afërt jetësorë;<br>Vëzhgon gjallesat dhe bisedojnë për çfarë kanë parë dhe,marrin informacione në media të ndryshme(TV. Ilustrime , libra,etj);<br>Vizatojnë me teknika të ndryshme bimët,shtazët,dhe imitojnë zëret e lëvizjet e tyre; | Tregon përgjegjësi për fjalën, sjelljet dhe veprimet e vet.<br><br>Njeh dhe kupton sjelljet e pranueshme dhe të papranueshme në mjedisin jetësor dhe të sillet konform tyre.<br><br>Din se edhe të tjerët kanë ndjenja e pikëpamje dhe nis dhe t`i vlerësojë ato.<br><br>I njeh dhe i kupton të drejtat e veta dhe të tjerëve dhe i respekton ato.<br><br>Kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe e kultivon atë.<br><br>Ka interes për botën bimore dhe shtazore.<br><br>Njeh dhe i kupton veçoritë e qenjeve të gjalla dhe jo të gjalla. |

**GRUP MOSHA 3 – 4**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 21. Të njoh e kuptojë veçoritë e qenjeve të gjalla dhe jo të gjallla<br><br>22. Të inkurajohet kërshëria për njohjen dhe të kuptuarit e dukurive natyrore<br><br>23. Të krijojë shprehi - të higjienës personale, të higjienës dhe kultivimit të ambientit, të sjelljeve të kulturuara dhe të punës<br><br>24. Të zhvillojë iniciativë për të hulumtuar mjedisin jetësor | Vëzhgon lëvizjen dhe e shqyrtojnë shkakun e saj ,kuptojnë se çka e kushtëzon lëvizjen.(njeriut i nevojitet ushqimi, makinës i nevojitet karburanti, mullirit uji apo era,);<br>Vëzhgon ndryshimet në mjedisin jetësorë në një cikël më të gjatë kohorë (vëzhgon ritën e luleve, këlyshëve etj.);<br>Bisedon për ngjarjet dhe krahason e konstaton renditjen e tyre, kohëzgjatjen,..etj (renditë fotografitë sipas kronologjisë, rindërton një tregim,konstaton kohën,…etj.);<br>Vëzhgon dukuritë natyrore si:qiellin , ylberin, hënën, rretë…etj.i përshkruan ato dhe kërkon informacione nga burime të ndryshme;<br>Luan dhe modelon me materiale të llojllojshme dhe njihet me veçoritë e materialeve, zbulon origjinën e tyre (balta, druri, lëkura, hekuri, magneti etj.<br>Konstrukton me materiale elastike dhe konstatojnë karakteristikat e tyre (teli, shkopitë elastik etj.);<br>Luan me ujë, rërë, borë, ajër,,…etj. i percepton ato dhe njihet me cilësitë e tyre dhe eksperimenton me këto. (përzien ujin me ngjyra,me substance të ndryshme,luan me rërë dhe formon figura të ndryshme, prekë borën dhe heton ndryshimin e gjendjes agregate të saj, luan me balona në ajër,…etj);<br>Bënë matje të sasisë me njësi jo standarde(gotë,lugë,shuplakë të dorës,…etj.<br>Bënë grumbullimin e materialeve të ndryshme –mbeturinave të veçanta dhe i riciklon ato. Zhvillon aktivitete punuese ku njeh dhe fillon ti kuptojë raportet midis njerëzve në proces të punës dhe vartësi reciproke me botën e gjallë dhe jo të gjallë; | Ka kërshëri për njohjen dhe të kuptuarit e dukurive natyrore.<br><br>Ka shprehi të higjienës personale, të higjienës dhe kultivimit të ambientit, të sjelljeve të kulturuara dhe të punës.<br><br>Tregon iniciativë për të hulumtuar mjedisin jetësor. |

**GRUP MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1.Të inkurajohet dësjira, nevoja dhe kërshëria për njohjen dhe të kuptuarit e vetvetes dhe botes.<br><br>2. Te krijojë situata jetesore per nxitjen dhe zhvillimin e kërshërisë për njohjen dhe të kuptuarit e vetes dhe botës.<br><br>3. Të mbështes dhe nxitet dhe inkurajohen për pse-të e vazhdueshme dhe vehet në situata të marrë apo zbulon pergjegjet.<br><br>4. Të nxitet dhe aftësohet për njohjen dhe të kuptuarit e identitetit persoanl (emri, mbiemri, mosha, gjinia, perkatesia familjare, profesioni i prinderve, perkatesia ambientale etj.)<br><br>5. Të zgjerojë përfytimet dhe të thellojë bindjet për atë që mund të bënë për veten dhe mjedisin jetësor. | Zhvillon aktivitete në të cilat ushtrojnë aftësinë e të vëzhguarit dhe të perceptuarit të trupit të vet;<br>Inicion aktivitete përmes lojërave imituese,dramatike,fiksimit,...etj .ku ushtrojnë imagjinatën;<br>Realizon aktivitete praktike,fitojnë përvojë dhe perceptojnë me vëmendje trupin vet dhe ndryshimet fiziologjike të organizmit në situata të ndryshme jetësore;<br>Në aktivitete të ndryshme kërkuese bëjnë identifikimin e ndijimeve dhe përmes eksperimentimit hetojnë veçoritë e gjësendeve dhe dukurive të mjedisit jetësorë;<br>Bisedon me të tjerët për ndijimet dhe përjetimet e tyre gjatë aktivitetit konkret;(luajnë lojëra për të qëlluar materialin e objekteve e gjësendeve...etj.);<br>Konstrukton me materiale të ndryshme për tu kënaqë dhe përjetuar suksesin e tij bisedojnë për emocione personale pozitive dhe ato të negative dhe dëgjojnë me kujdes shprehjet emocionale të tjerëve;<br>Bënë aktivitete në të cilat kërkohet durim dhe përpjekje për të quar punën deri në fund;<br>Komunikon për përparësitë dhe pengesat gjatë veprimeve të tyre në aktivitet dhe identifikojnë aftësitë e tyre;<br>Luan lojëra në të cilat mëson për të rezistuar dhe zgjidhur situatën problemore;(të përballen në situata konfliktuoze);<br>Bisedon e shqyrton me të tjerët për sjelljet e përgjegjshme të cilat afirmojnë individualitetin e tyre; | Shpreh dëshirë, nevojë dhe kërshëri në situata të ndryshme për njohjen dhe të kuptuarit e vetës dhe botës<br><br>Me guxim dhe vazhdimisht shtron pyetje, kërkon të marr përgjegjje apo zbulon përgjegje<br><br>Njeh dhe kupton identitetin personal (emri, mbiemri, mosha, gjinia, përkatësia familjare, profesioni i prindërve, përkatësia ambientale etj.)<br><br>Shpreh përfytyrimet dhe bindjet për atë që mund të bëjë për vetën dhe mjedisin jetësor<br><br>Shprehet me lëvizje , fjalë dhe krijime të ndryshme etj.<br><br>Heton, njeh e kupton emocionet e veta dhe të tjerëve dhe bashkëndjeson dhe vetpërmbahet |

**GRUP MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 6. Të kultivon imagjinaten dhe aftësitë e të shprehurit me lëvizje, fjelë dhe krijime të ndryshme etj.<br><br>7. Të hetojë, njohë e kuptojë emocionet e veta dhe të tjerëve dhe të zhvillojë aftësinë e bashkëndjesisë e të vetpërmbajtjes.<br><br>8. Të formësojë, shprehë e shpjegojë qëndrimet e veta.<br><br>9. Të aftësohet për tu identifikuar me personat dhe personazhet pozitive (nga familja, mjedisi socialjashtë familjar, në përmbajtjet artistike, as-media etj.)<br><br>10. Të aftësohet t'i gjykojë sjelljet negative personale apo sjelljet e shembujt negativ në mjedisin jetësorë.<br><br>11. Të zhvillohet siguria dhe vetbesimi. | Zhvillon aktivitete jo diskriminuese në të cilat mësohen për respektimin e gjinisë,prejardhjen sociale,kulturore,fetare,pamjen fizike...etj.;<br>Inkuadrohen në aktivitete në të cilat mësojnë rregullat e sjelljes së kulturuar ,përkatësisht zhvillojnë ndjesinë për të dëgjuar tjetrin,të respektojë autonomin personale dhe të individit tjetër si dhe përgjegjësinë për vendimet e ndërmarra së bashku;<br>Bënë pyetje dhe kënaqin kërshërinë për çështjet të cilat kanë interes.(për proceset jetësorë, frytëzimi,lindja,rita,shumëzimi,mplakja,...etj);<br>Bënë aktivitete në të cilat fiton përvoja konkrete me ndryshimin e roleve të gjinive të ndryshme në lojëra specifike dhe aktivitete ndryshme konkrete.(punët e amvisnisë , profesionet e ndryshme,...etj.);<br>Në lojëra simbolike identifikohen me persona e personazhe pozitive dhe përshkruajnë pozitiven në këto modele;<br>Bënë shëtitje dhe vizita për të fituar përvojë që të mbrojnë dhe ruajnë shëndetin.(të rruajnë shëndetin nga mikrobet,të mbrohen nga të ftohtit,helmimit,...etj.);<br>Dëgjonë këngë,tregime përralla,gjëegjëza të mjedisit të afërt dhe të kulturave të tjera përmes librit,tv. ilustrimeve ,...etj;<br>Bënë vizitë institucioneve të profileve të ndryshme si:biblioteka,teatri,muze,spital,shkollë, ...etj.dhe njihen me rolin e profesioneve të ndryshme; | Shprehë e shpjegon qëndrimet e veta<br><br>Tregon shenja të identifikimit me personat dhe personazhet pozitiv (nga familja, mjedisi social jashtë familjar, në përmbajtjet artistike, as-media etj.)<br><br>Gjykon sjelljet negative personale apo sjelljet e shembujt negativ në mjedisin jetësorë<br><br>Ka siguri dhe vetbesimi<br><br>Përballet me situatatat jetësore- mbron vetën dhe të tjerët<br><br>Përfundon detyrën e filluar, atë sfidese dhe që kryhet me vështirësi |

## GRUP MOSHA 4-5

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 12. Të nisë të shkathtësohet për tu përballuar me situatat jetësore ta mbrojë veten dhe të tjerët.<br><br>13. Të aftësohet të përfundojë detyrën e filluar, apo sfiduese dhe që kryhen me vështirësi.<br><br>14. Të njeh dhe ta kuptojë varësinë reciproke të tij dhe të mjedisit jetësor.<br><br>15. Të ketë përgjegjësi për fjalën, sjelljet dhe veprimet e veta.<br><br>16. T'i njoh dhe t'i kuptojë sjelljet e pranueshme në mjedisin jetësor dhe të sillet konform tyre.<br><br>17. T'i identifikojë e kuptojë dhe gjykojë sjelljet e papranueshme në mjedisin social.<br><br>18. Të kuptojë dhe vlerësojë ndjenjat dhe pikëpamjet e të tjerëve. | Bisedon për familjen e vet,ndjenjat e përkatësisë-familjes,grupit,dhe të njerëzve të tjerë jashtë familjes,shpreh përshtypjet e veta për punën që bëjnë,për ndjenjat ndaj tyre,për raportet midis tyre...etj;<br>Bashkëpunon në planifikimin dhe përgatitjet e kremtimit të festave apo manifestimeve të ndryshme duke respektuar dallimet e kulturave të ndryshme;<br>Luan dhe zhvillon aktivitete në të cilat duhet të respektojnë rregullat e paracaktuara si dhe të justifikojnë veprimet e tyre dhe të tjerëve në situata të ndryshme;<br>Zhvillon aktivitete në të cilat kërkohet ndërveprim me të tjerët për të arritur rezultatin e duhur pa e penguar tjetrin në aktivitet dhe vetëdijesimi për të drejtat e të tjerëve dhe të vetës;<br>Në aktivitete të përbashkëta respektojnë njeri tjetrin duke dalluar sjelljet e hijshme e të pa hijshme, ndihmohen kur është nevoja,(kur është i lënduar,i prekur ,i pikëlluar,...etj.);<br>Bënë shëtitje në natyrë,vizitojnë mjedise jetësore në të cilat kërkojnë,dallojnë,bëjnë krahasime, kujdeset dhe mirëmban botën bimore dhe atë shtazore;<br>Vëzhgonë dhe dallojnë ndryshimet në mjedisin jetësor,i përshkruajnë veçoritë karakteristike të tyre dhe i përcjellin zhvillimin e tyre për një kohë më të gjatë; | Njeh e kupton varësinë reciproke të tij dhe të mjedisit jetësor<br><br>Ka përgjegjësi për fjalën, sjelljet dhe veprimet e veta<br><br>Njeh dhe kupton sjelljet e pranueshme në mjedisin jetësor dhe të sillet konform tyre<br><br>Identifikon, kupton dhe gjykon sjelljet e papranueshme në mjedisin social<br><br>Kupton dhe vlerëson ndjenjat dhe pikëpamjet e të tjerëve<br><br>Kupton të drejtat e veta dhe të tjerëve dhe ti respekton ato.<br><br>Kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe e kultivon atë<br><br>Ka interes për ta kuptuar botën bimore dhe shtazore dhe ta kultivojë atë |

**GRUP MOSHA 4-5**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 19. Të zhvillojë kuptimin e të drejtave të veta dhe të tjerëve dhe t'i respektojë atë.<br><br>20. Të zhvillojë interesimin e mëtutjeshëm për botën bimore dhe shtazore dhe ta kultivojë atë.<br><br>21. Të njoh dhe kuptojë veçoritë e qenieve të gjalla dhe jo të gjalla.<br><br>22. Të inkurajohet kërshëria për njohjen dhe të kuptuarit e dukurive natyrore.<br><br>23. Të krijoj shprehi të higjienës personale, të higjienës dhe kutivimit të ambientit, të sjelljeve të kulturuara dhe të punës.<br><br>24. Të zhvillojë iniciativa për të hulumtuar mjedisin jetësorë. | Bisedon për ndodhitë e ngjarjet i konstatojnë ato dhe i renditin sipas kronologjisë , rëndësisë, cilësisë,...etj.<br>Vëzhgon dukuritë në natyrë i përshkruajnë verbalishtë dhe figurativishtë ato duke i kompletuar me informacione nga burime të ndryshme;<br>Modelon dhe konstrukton me materiale te llojllojshme dhe njihet me cilësitë e tyre dhe përpiqet të zbulojë përbërjen e tyre;<br>Vëzhgon dhe kupton shkakun e lëvizjes,të analizojë raportet shkak-pasojë;<br>Manipulon me mjete e materiale të ndryshme duke i njohur e zbuluar mundësitë e transformimit dhe të përdorimit të tyre;<br>Zhvillon lojëra të llojllojshme me ujë, rërë, baltë, borë, ajër,...etj të cilat i njeh dhe i kupton cilësitë e tyre (ngjyrën, gjendjen agregate, erën, peshën,vëllimin,...etj);<br>Eksperimenton në kërkim të zbulimit të vetive karakteristike të substancave tretëse dhe jo tretëse si dhe materieve të tjera në natyrë;<br>Në aktivitete të përditshme dhe ato të veçanta bënë matje të masave me njësi jo standarde (pëllëmbë të dorës, gotë, lugë, hapa të ecjes,...etj);<br>Grumbullon materiale të ndryshme ricikluese i seleksionon dhe i klasifikon ato sipas nevojës në aktivitetin përkatës;<br>Në aktivitete ndërvepruese me mjedisin jetësor kuptojnë raportet e vartësisë reciproke të tyre me botën. | Njeh dhe kupton veçoritë e qenjeve të gjalla dhe jo të gjallla<br><br>Shpreh kërshëri për njohjen dhe të kuptuarit e dukurive natyrore<br><br>Ka shprehi të higjienës personale, të higjienës dhe kultivimit të ambientit, të sjelljeve të kulturuara dhe të punës<br><br>Tregon iniciativa për të hulumtuar mjedisin jetësor |

## GRUP MOSHA 5-6

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 1. Të jetë i inkurajuar të thellojë më tutje dëshirat, nevojat dhe kërshërinë për njohjen dhe të kuptuarit e vetës dhe botës<br><br>2. Të krijojë situata jetësore për nxitjen dhe zhvillimin e kërshërisë për të njohur dhe të kuptuar veten, botën dhe ndryshimin e saj për nevojat e njeriut<br><br>3. Të mbështetet, nxiten e inkurajohen pyetjet e vazhdueshme , të vehen në situata të marrin apo zbulojnë përgjegjet, të bisedojnë për shkakun dhe pasojën<br><br>4. Të nxitet e aftësohen për njohjen dhe të kuptuarit e identitetit personal (emri, mbiemri, mosha, gjinia, përkatësia familjare, profesioni i prindërve, përkatësia ambientale, ajo kombëtare-gjuha, teritori, simbolet etj.)<br><br>5. Të zgjërojë përfytyrimet dhe të thellon bindjet për atë që mund të bëjnë për vetën dhe mjedisin jetësor si dhe kufizimet për të bërë | Zhvillon aktivitete në të cilat realizohet vëzhgimi e veprimeve të trupit të vet dhe me vetëbesim percepton shprehjen e vetës në detyrat personale;<br>Studion trupin e vet, funksionalitetin e organeve të trupit në realizimin e veprimeve konkrete;<br>Bisedon me të tjerët për shkathtësitë apo ngathtësitë e trupit të vet në veprimtari të caktuara;<br>Përmes aktiviteteve të veçanta praktike ushtrojnë ndijimet(të prekurit,të parit, nuhatjes,..)i identifikojnë dhe i përshkruajnë në mënyrë verbale çfarë kanë hetuar.(cilësitë e materialit,dukurive,gjësendeve...);<br>Konstrukton me materiale të llojllojshme me të cilat krijojnë produkte nga të cilat fitojnë vetëbesim në të arriturat e tyre;<br>Bënë aktivitete më komplekse të cilat kërkojnë kohë dhe qëndrueshmëri më të fortë për ti realizuar ato;<br>Bisedon për përjetimet e tij gjatë aktivitetit duke bërë identifikimin e emocioneve të këndshme dhe ato të pa këndshme;<br>Në aktivitete komunikon për përparësitë dhe dobësitë personale dhe janë të hapur në sugjerimet e të tjerëve;<br>Zhvillon aktivitete –pyetje-përgjigje në tema të cilat kanë interes;<br>Bënë aktivitete duke shfrytëzuar shkathtësi adekuate sociale pa dallim gjinorë,marinë role të gjinisë së kundërt; | Shpreh dëshirë, nevojë dhe kërshëri për njohjen dhe të kuptuarit e vetës dhe botës<br><br>Në situata jetësore është i nxitur dhe ka kërshëri për njohjen dhe të kuptuarit e vetës dhe botës dhe ndryshimin e saj për nevojat e njeriut<br><br>Pyet, kërkon merr dhe zbulonë përgjegjet, bisedonë për shkakun dhe pasojën<br><br>Njeh dhe kupton identitetit personal (emri, mbiemri, mosha, gjinia, përkatësia familjare, profesioni i prindërve, përkatësia ambientale, ajo kombëtare-gjuha, teritori, simbolet etj.)<br><br>Eshtë i bindur për atë që mund të bëjnë për vetën dhe mjedisin jetësor si dhe kufizimet për të bërë<br><br>Shpreh imagjinatën me lëvizje, fjalë dhe krijime të ndryshme etj. |

**GRUP MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 6. Të kultivojë imagjinatën dhe aftësitë e të shprehurit me lëvizje , fjalë dhe krijime të ndryshme etj.<br><br>7. Të hetojë, njoh e kuptojë emocionet e veta dhe të tjerëve dhe të zhvillojë aftësinë e bashkëndjesisë e të vetpërmbajtjes.<br><br>8. Të formësojë, shprehë e shpregojë qëndrimet e veta dhe të tregojë tolerance ndaj mendimit ndryshe të tjetrit<br><br>9. Të aftësohet për t`u identifikuar me personat dhe personazhet pozitiv(nga familja, mjedisi social jashtë familjar, në përmbajtjet artistike, ms-media etj.)<br><br>10. Të aftësohet t`i gjykojë sjelljet negative personale apo sjelljet e shembujt negativ në mjedisin jetësorë<br><br>11. Të zhvillohet siguria,vetbesimi dhe pavarësia | Luan lojëra të llojllojshme simbolike në të cilat modelojnë sjellje dhe veprime mbi bazën e personave dhe personazheve pozitive;<br>Në aktivitetet e përditshmërisë praktikisht mëson për preventivën e ruajtjes së shëndetit(mënyrën e të ushqyerit të shëndoshë,nevojat e tjera fiziologjike,mbrojtja nga infektimet,..etj);<br>Zhvilloë aktivitete në të cilat zgjerojnë njohuritë për historitë e njerëzimit,kulturën e popullit të vet dhe të tjerëve;<br>Bënë vizita në komunitetin e afërt në shkollë,teatër,bibliotekë,postë,...etj.dhe komunitete të tjera me të cilat njihet përmes librave, ilustracioneve, filmit,tregimeve përrallave,...etj.;<br>Bisedonë për familjen e vet dhe familje të tjera,japin sqarime për drejtimin e vendimit të shtëpisë,pikat e referimit për t'u gjendur në hapësirë;<br>Bashkëpunon në përgatitjen e kremteve të ndryshme dhe mësojnë t'i respektojnë dallimet e kulturave të ndryshme;<br>Tregon tregime dhe rrëfime nga fëmijëria e hershme, si ka qenë dhe çfarë ka bërë në situata e raste të veçanta;<br>Diskuton për sjelljet e përgjegjshme të cilat janë afirmative për zhvillimin e personalitetit të shëndoshë;<br>Flet për sfidat në botë dhe diskuton për sigurinë dhe të drejtat e tyre gjinore, sociale, fetare, kulturore...etj.; | Heton, njoh e kupton emocionet e veta dhe të tjerëve dhe të zhvillon aftësinë e bashkëndjesisë e të vetpërmbajtjes<br><br>Shprehë e shpregonë qëndrimet e veta dhe tregonë tolerancë ndaj mendimeve ndryshe të tjetrit<br><br>Identifikohet me personat dhe personazhet pozitiv (nga familja, mjedisi social jashtë familjar, në përmbajtjet artistike, ms-media etj.) dhe shpjegon shkakun e identifikimit<br><br>Gjykon sjelljet negative personale apo sjelljet e shembujt negativ në mjedisin jetësorë<br><br>Ka siguri, vetbesimi dhe pavarësia- autonomi të personalitetit<br><br>Përballet me situatata jetësore-mbron vetën dhe të tjerët<br><br>Përfundon detyrën e filluar, ato sfidese dhe atë që kryhet me vështirësi dhe të flet lirshëm për vështirësitë-tregon shenja të mburrjes |

## GRUP MOSHA 5-6

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 12. Të nis të shkathtësohet për t`u përballur me situatatat jetësore- ta mbroj vetën dhe të tjerët<br><br>13. Të aftësohet të përfundojë detyrën e filluar, ato sfidese dhe që kryhen me vështirësi dhe të flas lirshëm për të<br><br>14. Të njoh e ta kuptojë varësinë reciproke të tij dhe të mjedisit jetësor<br><br>15. Të ketë përgjegjësi për fjalën, sjelljet dhe veprimet e veta<br><br>16. T`i njoh dhe t`i kuptojë sjelljet e pranueshme në mjedisin jetësor dhe të sillet konform tyre<br><br>17. T`i identifikojë e kuptojë dhe gjykojë sjelljet e papranueshme personale dhe të të tjerëve<br><br>18. Të kuptojë dhe vlerësojë ndjenjat dhe pikëpamjet e të tjerëve | Bëne aktivitete përmes së cilave mësojnë për mirëkuptimin ndaj të tjerëve dhe marinë iniciativë për t'i ndihmuar,anëtarëve të familjes dhe njerëzve në moshë si dhe atyre me aftësi të kufizuara;<br>Aktivitete praktike përmes të cilave mësonë rregullat e sjelljes së kulturuar si:respektimi i pronës, autonomisë së individit,ndarje të përgjegjësive etj,;<br>Bënë shëtitje në natyrë dhe në mjedise të tjera kulturore në të cilat njohin ,kërkojnë ,analizojnë kujdesën dhe i mirëmbajnë ato;<br>Viziton kopshtin zoologjik,dhe mjedise të tjera në të cilat njihen me botën shtazore dhe bimore;<br>Vëzhgojë gjallesat dhe këmbejnë përshtypjet e tyre për to ,marrin informacione nga burimet e ndryshme si: tv, ilustrimet, librat,filmi,...etj.;<br>Modelojë e vizatojnë me mjete e materiale të ndryshme në bazë të modelit apo përfytyrimeve gjësendet dhe gjallesat e mjedisit jetësorë;<br>Zhvillojë aktivitete përmes së cilave kuptojnë raportet shkak-pasojë parashikojnë përfundimin;<br>Vëzhgojë ndryshimet në mjedisin jetësorë në një cikël më të gjatë kohorë;<br>Interpreton ngjarjet dhe bisedon me të tjerët për to, i krahason dhe bënë radhitjen e ngjarjeve,dukurive sipas kronologjisë apo ndonjë kriteri tjetër;<br>Vëzhgojë dukuritë natyrore,shiun,erën,qiellin,ylberin,..etj pyet dhe kërkon informacion nga të tjerët dhe nga burimet e tjerë; | Njeh dhe kupton varësinë reciproke të tij dhe të mjedisit jetësor<br><br>Ka përgjegjësi për fjalën, sjelljet dhe veprimet e veta<br><br>Njeh dhe kuptonë sjelljet e pranueshme në mjedisin jetësor dhe të sillet konform tyre<br><br>Identifikon, kuptonë dhe gjykonë sjelljet e papranueshme personale dhe të të tjerëve<br><br>Kupton dhe vlerëson ndjenjat dhe pikëpamjet e të tjerëve<br><br>Kupton të drejtave të veta dhe të tjerëve dhe kërkon t`i respektojë ato<br><br>Kujdeset, mbron e kultivon mjedisit jetësor<br><br>Tregon interes për botën bimore dhe shtazore dhe e kultivonë atë<br><br>Ka njohuri dhe aftësi ta kuptojë botën e gjallë dhe jo të gjallë |

**GRUP MOSHA 5-6**

| OBJEKTIVAT E VEÇANTA | AKTIVITET E MUNDSHME TË FËMIJËS | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| 19. Të zhvillojë kuptimin e të drejtave të veta dhe të tjerëve dhe t`i respektojë ato<br><br>20. Të kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ta kultivojë atë<br><br>21. Të zhvillojë interesin e më tutjeshëm për botën bimore dhe shtazore dhe ta kultivojë atë.<br><br>22. Të thellojë e kuptojë njohuritë për botën e gjallë dhe jo të gjallë<br><br>23.Të inkurajohet kërshëria për njohjen dhe të kuptuarit e dukurive natyrore<br><br>24. Të krijojë shprehi - të higjienës personale, të higjienës dhe kultivimit të ambientit, të sjelljeve të kulturuara dhe të punës.<br><br>25. Të zhvillojë iniciativa për të hulumtuar mjedisin jetësor | Konstrukton e bënë modelime më materiale të llojllojshme dhe njihet me veçoritë tyre dhe vetitë e transformimit në formë e përmbajtje tjetër;<br>Bënë shëtitje në natyrë në të gjitha stinët e vitit dhe njihet me ndryshimet atmosferike e veçori të tjera në këto stinë të vitit;<br>Punon kalendar vjetorë dhe bëjnë paraqitjen grafike të ngjarjeve dhe fenomeneve natyrore në te;<br>Eksperimenton me ujë,rërë,borë,dhe në ajër dhe njihen me veçoritë e tyre dhe ndryshimet e tyre agregate;<br>Bënë matje me njësi jo standarde(gotë,lugë,hapa të ecjes,..etj.);<br>Grumbullon materiale ambalazhi dhe ato të cilat kanë përdorim riciklues i seleksionojnë sipas cilësisë për t'i shfrytëzuar ;<br>Zhvillon aktivitete në të cilat mësojnë për rregullat e protokollit të dokeve e zakoneve tradicionale dhe të atyre civilizuese.(zakonet kombit të vet e të popujve të tjerë);<br>Bënë aktivitete përmes të cilave fillojnë të kuptojnë varësinë reciproke midis tij dhe botës së gjallë dhe jo të gjallë. | Ka kërshëri për njohjen dhe të kuptuar e dukurive natyrore- shkakun dhe pasojën<br><br>Ka shprehi të higjienës personale, të higjienës dhe kultivimit të ambientit, të sjelljeve të kulturuara dhe të punës<br><br>Tregon pavarësi dhe kreativitetet në iniciativa për të hulumtuar mjedisin jetësor |

**VI. 5. 11. Integrimi ndërfushorë**

Përdorimi i **lendës** apo **temës** për integrim në **Web format** të përvojave të mësimit përgjatë kurrikulës

## **Web shembulli 1:** Të qenit të shëndetshëm

**Fushëveprimet dhe aktivitetet e kurrikulës**

Duke përdorur një **lendë** apo **temë**, fëmijëve u ofrohet mundësia që të mësojnë për vetveten se çka dijnë dhe çka munden. Ata mund të punojnë në mënyrë të pavarur, kurse mësuesi mund t'u ndihmojë në zhvillimin e aftësive dhe ideve të tyre.
Mësuesi mund të përdorë këtë **web format,** për t'i planifikuar përvojat kyçe për fëmijët, bazuar në aftësitë dhe interesimin e tyre.

**Të qenit të shëndosh**

***Edukata fizike***

*Aftësitë e vështira motorike*: gjuajtja e topave, vrapimi, kërcimi, të kërcyerit si karkalec, hedhja , garimi, lojërat
*Aftësitë e lehta motorike*: kapja e topave, topat energjik
*Balansi*: vetë-dijësimi, përcjellja e linjës, ngjitja në konizë, kolovajza, gara në tri këmbë
*Vetëdijsimi social*: lojërat e përbashkëta, ekipet
*Zierja dhe ushqimi*: cila është dieta e shëndetshme
*Higjiena*: loja e kuzhinës dhe e banjos, larja dhe pastrami
*Aksidentet*: çfarë duhet të bëhet në rast të vetëlëndimit apo në rast të lëndimit të

**Arti**

*Vizatim dhe ngjyrosje:*: anëtarët e familjes, kujdesi ndaj tyre, skena nga jeta familjare, aksidentet dhe përshkrimi i tyre.
*Vërejtja e ndryshimit:*: vizatimi i bimëve, njerëzve në faza të ndryshme të jetës , në bazë të observimit.
*Modelimi*: modelimi i shtëpive, strehimoreve, dhe i gjërave që ju ofrojnë siguri.
*Kolazhe:* mbështjelljeset e ushqimit të shëndetshëm dhe ushqimit jo të shëndetshëm.

**Muzika**

*Këngë*: që tregojnë shëndetin dhe rritjen
*Vallëzim*: që tregojnë ciklin e jetës së njerëzve, fluturave dhe krijesave tjera.
*Lozja në instrumente muzikore:*: lozja në instrument e mëshuarjes dhe muzikës së incizuar.

**Matematika**

*Diagramet e zhvillimit*: vizatim, matje, vizatimi I diagrameve, krahasimi I rritjes gjate kohës, diferencat në grup
*Enigmat( puzzle), lojrat*: me anën e informacioneve relevante mbi shëndetin, punimi i enigmës( puzzle) apo fotografie të skenës në spital
*Letrat logjike*: çfarë të bëhet para 'çka' për shëndet dhe siguri
*Parashikimet:* ndryshimet e kohës, si duhet të vishem, pse
*Llogaritja:* sa është sasia e nevojshme për shëndet të mire, çfarë do të thotë 'shumë' sheqer?
*Organizimi dhe klasifikimi:* vendosja e çdo gjëje ne vend të vet, për ta mbajtur ambientin e sigurtë

**Gjuha**

*Përvoja e të qenit i/e sëmurë*: diskutimet, përsëritja e përvojave
*Planifikimi dhe mbajtja e shënimeve*: si mund ta dijmë se jemi të shëndoshë?Mbajtja e shënimeve rreth gjendjes shëndetsore dhe çfarë mund të bëjmë
*Të shkruarit*: vizita te mjeku, në barnatore, vizita e një të afërmi të sëmuar
*Tregimet dhe librat e bazuar mbi jetën*: temat mbi shëndetin, zhvillimin, rendësinë e ujit për jetë dhe shëndet, tregimet mbi atletët dhe njrëzit e forte
*Bërja e një 'fletoreje shënimesh':* përkujdesja për një foshnje, vllaut apo motrës më të re

**Njohja e vetvetes dhe botës përreth**

*Lozja e rolit/drama:* lozja e rolit të pacientit, mjekut. motrës medicinale, fëmiut të sëmurë në shtëpi.
*Lozja e frikës*: nga aksidenti, lëndimet, dhe ç"duhet bërë në këto raste
*Shfaqje me kukulla*: përshkrimi I veseve të këqia të ushqimit dhe të të ushqyerit.
*Vizitat e komunitetit*: çka duhet të zgjedhim në supermarket, që të jemi të shëndetshëm,dhe pse
*Çështjet ambientale*: rëndësia e ajrit të pastër, psh. Fryerja e balonit, testimi I kapacitetit të mushkërive, rreziku nga pirja e duhanit

Përdorimi i **lendës** apo **temës** për integrim në **Web format** të përvojave të mësimit përgjatë kurrikulës

**Shembujt tjerë:**

***Rritja e bimëve***

Ndërtimi i shtëpisë
Çfarë ndodhë në fermë?
Si punon supermarketi
Si punon biçikleta
Si të ndërtohet dhe vendoset një shtëpizë për zogj
Krahasimi i qytetit dhe fshatit
Cila është puna e një motre medicinale?
Një ditë  në jetën e një gjiganti
Fillimi i shkollës

Përdorimi i **lendës** apo **temës** për integrim në **Web format** të përvojave të mësimit përgjatë kurrikulës

***Shembull:***

